

92

N29



NAUN
PRIETI (DOKO)

92

1429

~~23528~~

S

23528
BIBLIOTEKA E SHKENCË
GJYEQASIA

NAUN GRIGOR PRIFTI (DOKO)
(REVOLUCIONAR KOMUNIST)

N. SH. BOTIMEVE «NAIM FRASHËRI»
TIRANË, 1962

Pregatitur nga Esat Reso

Tirazhi: 1500

Formati 70X100/32

STASH: 2204-55

Shtypur në N.I.Sh. Shtypshkronjave «MIHAL DURI» Tiranë

3831 SHANIT

NAUN GRIGOR PRIFTI (DOKO)

(24 qershor 1898 — 10 maj 1934)

Naun Grigor Prifti (Doko) (1) zë një vënd të rëndësishëm në lëvizjen patriotike dhe revolucionare të vëndit tonë. Ai jetoi, u rrit dhe u brumos në gjirin e popullit të shtypur e të shumëvuajtur myzeqar me ndjenjat e urrejtjes kundër shfrytëzuesve-bejlerëve dhe agallarëve gjakpirës. Popullin, që ai e donte shumë, nuk e harroi për asnjë çast edhe kur ai ishte i mërguar me mijëra kilometra larg atdheut. Ja me sa ngrohtësi, mall dhe besim i shkruante ai, në vitin 1929, nga Abastumani, një kushuriut të tij në Shqipëri: «Mbamë në kujtim, kushëri i dashur, e mos më qit në harresë gjersa të vinjë dit' e mirë e të hasemi. Ajo ditë nuk është shumë larg».* Por tuberkulozi, që ai fitoi nga burgu, vuajtjet, mundimet dhe puna intensive, e shkëputën në moshë të re nga jeta, nga populli, nga të afërmit dhe shokët e tij. Nauni vdiq larg atdheut, por në mes të miqve dhe shokëve të tij sovjetikë, të cilët e donin dhe e respektonin për cilësitë e tij bolshevike. «Gruzia — shkruante ga-

* A. Q. P. Fondi personal i Naun Priftit.

zeta «Zarja Vostoka»,** më 23 shkurt 1960, — ka kujtime të ngrohta nga jeta dhe veprimtaria, në Republikën tonë, e patriotit revolucionar shqiptar Naun Grigor Prifti».

Partia jonë e Punës ka treguar një kujdes të veçantë për të nxjerrë në shesh veprimtarinë revolucionare të komunistit Naun Prifti, i cili më përpara nuk njihej në vëndin tonë. Me kujdesin e Komitetit Qëndror të Partisë dhe personalisht Shokut Enver Hoxha u sollën nga Tiflisi disa sende të tij personale, me të cilat u hap një kënd në Muzeumin e Fierit dhe u vu në dukje me anë të shtypit figura e këtij revolucionari myzeqar.

* * *

Jehona e Revolucionit të madh socialist të Tetorit u përhap edhe në vëndin tonë. Idetë e Leninit po lëshonin rrezet e para të dritës edhe në skajat më të humbura të Shqipërisë, edhe te myzeqarët e shtypur, të zbathur, të rreckosur dhe të uritur. Nauni, i pajisur me ndjenja të larta patriotike, i përqafoi këto ide revolucionare dhe me durim i tregoi bujkut të Myzeqesë se rruga e shpëtimit nga skllavëria e bejlerëve dhe e çifligarëve gjakpirës ishte vetëm ajo e treguar nga Lenini i madh. Duke ndjekur këtë rrugë revolucionare, populli i shtypur i Myzeqesë u hodh në luftë kundër okupatorëve dhe tradhëtarëve, u bashkua në kooperativat bujqësore dhe punon

** Organ i Komitetit Qëndror e i komitetit të Tbilisit të P.K. të Gruzisë dhe i Sovjetëve të deputetëve të punonjësve të Republikës Socialiste Sovjetike të Gruzisë).

dhe jeton i gëzuar, i lumtur. Myzeqeja, që dje ishte çerdhe e malarjes, e urisë dhe e paditurisë, sot ka ndryshuar rrënjësisht. Bijtë e ish fshatarëve të varfër e të rreckosur janë bërë agronomë, mjekë dhe punëtorë të dalluar. Nauni, bir i krahinës së Myzeqesë, nuk jeton më, por ideali dhe qëllimet e tij u realizuan nën udhëheqjen e Partisë marksiste-leniniste të Punës, e cila po e çon popullin tonë nga fitorja në fitore.

Kujdesi, dashuria dhe respekti i treguar nga Nauni për fshatarët e varfër të Myzeqesë akoma janë të freskëta në kujtesën e këtyre. Këto do të mbeten përgjithmonë të skalitura në zëmrat e tyre dhe të brezave të ardhshëm. Kushërinjtë, miqtë, shokët dhe bashkëfshatarët e tij shprehin me mirënjohje të thellë kujdesin e Partisë sonë të punës. Ja si i shkruan «Zërit të Popullit» një nga të afërmit e tij: «Po bëhen më shumë se dy vjet që doli në dritë revolucionari komunist Naun Grigor Prifti... Kjo i detyrohet Partisë sonë të Punës, e cila tregon një interes kaq të madh për gjithë njerzit, që kanë punuar për të mirën e Shqipërisë».

Për ta bërë më të njohur figurën e dashur të këtij revolucionari komunist do të japim biografinë e shkurtër të tij, disa pjesë nga letrat e tij dhe nga kujtimet e atyre, që e kanë njohur Naunin përsëafërmi.

* * *

I

BIOGRAFI E SHKURTËR

Naun Grigor Prifti (Doko) lindi më 24 qershor 1898 në fshatin Libofshë të rrethit të Fierit nga një familje fshatarësh të mesmë, por që ishte në gjëndje të keqe ekonomike. Ai qysh në moshën e njomë të fëminisë e shëtiti këmbëzbathur tokën e Myzeqesë dhe i hoqi mbi kurrizin e tij hallat, vështirësitë dhe brengat e jetës së mjeruar të fshatarëve të shtypur nga bejlerët dhe agallarët gjakpirës. Nauni ishte i zgjuar, i shkathët dhe i patrembur nga vështirësitë.

Ai mësimet e para i mori në shkollën fillore shqipe të Libofshës, që u hap në vitin 1908 nga mësuesi Jovan Ndreko, i cili abetaret dhe librat i sillte nëpërmjet miqve atdhetarë nga Bukureshti.

Nauni mësonte mirë, ishte studios dhe dallohej ndër të tjerët. Ja si shkruan për 'të bashkënxënësi i tij, fshatari Thoma Josif Bregu: «Unë Naunin e kam njohur mirë që në vogëli në bangot e para të shkollës. Në shkollë dallohej për zgjuarësi e inisjativë, ishte njeri që nuk trembej

dhe studjor i madh»* Pasi mbaroi shkollën në Libofshë, vazhdoi shkollën e mesme, që e kreu në vitin 1915 dhe pastaj u muar me punë të bujqësisë në fshat.

Më vonë, pasi ndoqi kurse pedagogjike, në 1919 u emërua mësues, profesion që ai e ushtroi me zell dhe pasion të madh. Nauni, duke qënë mësues, filloi të hyjë në kontakt me arësimtarë përparimtarë dhe me revolucionarë të njohur. Ai u fliste fshatarëve për luftën, që duhej të bënin kundër bejlerëve e agallarëve dhe u tregonte se si fshatarët, në Rusi, kishin marrë tokën. Nauni jetoi në ato vite, kur në Shqipëri zhvilloheshin ngjarje të rëndësishme për të ardhmen e popullit tonë. Ekzistenca e shtetit shqiptar po kërcënohej seriozisht. Imperialistët bënin pazarllëqe, që ta copëtonin Shqipërinë. Në momerandumin e 9 dhjetorit 1919 Anglia dhe Franca aprovonin aneksimin e Vlorës e të rrethit të saj nga ana e Italisë e mandatin italian mbi shtetin shqiptar të gjymtuar. Në këto çaste kritike lëvizja antiimperialiste në Shqipëri për clirimin kombëtar po merrte përpjestime gjithnjë më të mëdha dhe, si rrjedhim, u krijuan organizata kombëtare antiimperialiste, të cilat filluan veprimtarinë e tyre për mobilizimin e popullit në luftë kundër imperializmit. Gjatë vitit 1919 në Tiranë, Elbasan, Berat, Fier etj. u zhvilluan mitingje popullore, që shprehnin protestën dhe urrejtjen e madhe të masave kundrejt planeve të fshehta djallëzore të imperialistëve grabitqarë, të cilëve për herë të parë ua hoqi maskën V.I. Lenini.

* A.Q.P. Kujtime të Thoma Bregut për «Naun Priftin».

duke shkruar më 1917: «Çdo njeri që lexon gazetë dhe e ka studjuar këtë çështje, e di se në këto trakte flitet për grabitjen e Kinës nga ana e Japonisë, për grabitjen e Persisë, Armenisë, Turqisë, Galicisë nga ana e Rusisë, të Shqipërisë nga ana e Italisë. . . .»*

Kjo mbrojtje që u bënte Lenini popujve të vegjël ngjalli një simpati të veçantë edhe midis popullit tonë, aq sa më 1924, me rastin e vdekjes së tij patrioti Avni Rustemi tha në parlament këto fjalë:

«E dini fare mirë, zotërinj, se qysh ai mbrojtja ti principet e larta të njerëzisë e se qe i pari që denoncoi traktatin e fshehtë të 1915-ës²⁾, që ishte për copëtimin e Shqipërisë. . . . E kemi për detyrë që të bëhen 5 minuta pushim si shenjë hidhërimi për vdekjen e tij».**

Njësi të armatosur vullnetarësh shqiptarë gëdhitnin autokollonat ushtarake dhe postkomandat e karabinierisë italiane. Më 28 Nëntor 1919, në Vlorë, shpërtheu përsëri një demonstratë e fuqime kundër pushtuesve italianë.

Populli kërkonte me këmbëngulje rrëzimin e Qeverisë tradhëtare të Durrësit³⁾ dhe krijimin e një qeverie, që të hidhte poshtë traktatin e Londrës dhe të ruante lirinë dhe integritetin e Shqipërisë. Lëvizja patriotike përfshiu masat e gjëra popullore.

Në këto çaste të rënda për lirinë dhe ekzistencën e popullit tonë Naun Prifti zhvilloi në masat një propagandë të gjërë antiimperialiste

* V.I. Lenin — V. 23 f. 327, botim rus.

** Historia e Shqipërisë (1919-1939) — Dega e botimeve të Universitetit Tiranë 1961, faqe 183.

dhe demaskoi bejlerët dhe imperialistët italianë, që kishin pushtuar vendin tonë. Për këtë veprimtari revolucionare dhe antiitaliane ai u diktua dhe u arrestua nga pushtuesit italianë, të cilët e burgosën në Babicë 4 të Vlorës dhe pastaj e dërguan në burgjet e Italisë, ku qëndroi një vit (1919-1920). Pak kohë para fillimit të luftës së Vlorës Nauni u këthye në Shqipëri. Pas lirimit nga burgu Nauni e vazhdoi edhe më me forcë veprimtarinë e tij revolucionare dhe antiimperialiste. Ai u fliste fshatarëve me urrejtje kundër imperialistëve italianë dhe u thoshte se armiku duhej luftuar e nuk duhej ndenjtur me duar kryq.

Lufta e masave popullore kundër pushtuesve italianë po zhvillohej e ashpër. Armiku ishte struktur në Vlorë, ku, më 6 qershor 1920, filloi arrestimet dhe masakrat në masë.

Nga të katër anët e vëndit shkuan vullnetarë. Naun Prifti, i cili para pak kohe ishte këthyer nga internimi, bashkë me 50 luftëtarë shkoi në Vlorë, ku bashkë me fuqi të tjera mori pjesë në luftime, gjer sa italianët u hodhën në det. Ja si shkruan bashkëfshatari i tij Marko Prifti: «Pas dy muajve e pashë në krye të një grupi prej 50 burrash me flamur në dorë përmes fshatit tonë, duke kënduar këtë këngë revolucionare:

«Merr uratën, bir, prej meje
edhe armët i gatit,
se erth dita e shënuar,
Dolli ylli e na ndrit» *

Pas çlirimit të Vlorës ai u këthye përsëri në Myzeqe, ku vazhdoi punën e tij revolucionare.

* A.Q.P. «Kujtime për Naun Priftin» nga Marko Prifti. (Këto janë vargje të Mihal Gramenos).

vënde të tjera, fshatarët e Myzeqesë u organizuan në degët e shoqërisë «Bashkimi». Nauni kishte fituar zëmrat e njerëzve me sjelljet, vendosmërinë dhe zgjuarësinë e tij. Edhe ish nxënësit e shkollës fillore flasin me mall dhe ngrohtësi prindërore për mësuesin e tyre të dashur. Ish nxënësi i shkollës fillore, në Fier, Jorgji Xoxa, shkruan kështu: «Ne prisnim me padurim orën e mësimit, që kishim me të dhe dëshpëroheshim kur mungonte. Nauni kishte fituar zemrat tona të njoma dhe të sinqerta, ai sillej si prind dhe si shok». Nauni ishte i dashur me popullin dhe i ashpër me armiqtë dhe tradhëtarët, të cilët e kishin halë në sy dhe donin ta zhduknin. Me fshatarët, me nxënësit dhe me të gjithë Nauni fliste me urrejtje të madhe kundër bejlerëve Vrionas, që i pinnjakun e popullit. Vrionasit, duke parë se Nauni përbënte një rrezik të madh për ta dhe për regjimin reaksionar ekzistues, bënë çmos dhe e pushuan nga puna si mësues, por ai asnjëherë nuk u përkul, përkundrazi edhe më me hov, krenar dhe i patundur e vazhdoi punën e tij revolucionare, duke pasur besim të plotë në fitoren e popullit.

Jorgji Xoxa, ish nxënësi Naunit në shkollën fillore të Fierit, shkruan se në vitin 1921, kur bejlerët e pushuan nga puna si mësues për veprimtarinë e tij revolucionare, u ka folur kështu nxënësve të klasës së tij:

«Të dashur fëmijë! Sot, sikundër shihni, kam ardhur në klasë pa regjistër, sepse nuk erdha të jap mësimin, por të përshëndetem me ju. Nuk gjej fjalë për të treguar se sa keq më vjen që të ndahem nga ju, brezi i së ardhmes i Atdheut tonë të dashur, që sot vuan nën zgjedhën e feudalëve.



Naun Prifti dalë me krabë në dorë në vitin 1923 në
Lushnjë,

Bejlerët e Vrionasve na kanë halë në sy, atyre u rrija si kockë në fyt, sepse unë ju flisja mbi minoritetë e tyre dhe të shokëve të tyre, mbi vuajtjet e popullit nga këta satrapë. Për këtë ata demarshuan ku duhet dhe mua më pushuan. Por ju, të dashur fëmijë, t'i kini gjithmonë parasysh këshillat e mia dhe që të jini të denjë për emrin bijtë e shqipes, të luftoni për popullin. Ja ku po jau them, do të vijë dita që populli do t'ua thyejë turinj të bejlerëve».*

Në këto vite ngjarjet zhvilloheshin me një shpejtësi të madhe. Forcat demokratike dhe përparimtare luftonin kundër forcave të errësirës, që kërkonin ta zhytnin popullin tonë në një zgjedhë të rëndë dhe mizore. Idetë e Revolucionit Socialist të Tetorit kishin filluar të përhapeshin në vëndin tonë dhe kishin bërë me vete njerëz përparimtarë dhe masa. Ja si shkruante revolucionari Mihal Grameno në gazetën «Koha» në Tetor 1923: «Popujt po zgjohen dhe pyesin «rrojtje është kjo tona?» Kjo po i shtyn dita me ditën në idealin e lirisë së vërtetë, e cila është bolshevizma». Në këto rrethana të një ngritjeje revolucionare u rrit dhe u brumos revolucionari myzeqar Naun Prifti, i cili lulen e rinisë, jetën dhe mëndjen e tij e shkriu për çështjen e popullit, që ai e donte aq shumë. Në fillim të vitit 1924 filloi të zhvillohej një krizë revolucionare. Asambleja Kushtetuese e asaj kohe u bë arena e një lufte të ashpër politike midis dy blloqeve kundërshtarë. Deputetët demokratë luftonin për formimin e një qeverie përfaqësuese me baza të gjëra parlamentare, që të ishte e aftë të mbronte interesat e popullit.

* A.Q.P. Kujtime për Naun Priftin nga Jorgji Xoxa, Fondi personal i Naun Priftit.

Qeveria reaksionare e feudalëve dhe agjentëve të imperializmit përdori të gjitha mënyrat për të dobësuar lëvizjen demokratike. A. Zogu — mbrojtës i çifligarëve dhe tiran i popullit — më 20 prill 1924, organizoi atentatin kundër Avni Rustemit, i cili pas dy ditëve vdiq. Me vrasjen e Avniut u mbyllën të gjitha shtigjet për luftë legale. Vrasja e udhëheqësit të shquar të «Bashkimit»* e indinjoi thellë gjithë popullin shqiptar. Nga të katër anët e atdheut erdhën protesta për këtë vrasje të poshtër. Ja si thuhet në telegramin e një grupi të rinjsh nga Vlora, me Halim Xhelon⁸ e Riza Cërovën⁹ në krye, drejtuar Avni Rustemit me rastin e plagosjes së tij më 20 prill 1924: «Goditja e trupit tënd të shenjtë është pika e nisjes së një periudhe që do të përtërijë gjallërinë e nacionalizmës. Plumbi feudal ka goditur idealin shqiptar».**

Me këtë urrejtje të madhe u shprehën gjithë masat punonjëse kundër dorës tradhëtare të klikës reaksionare, që vranë patriotin demokrat — Avni Rustemin. Varrimi i Avni Rustemit në Vlorë u shndërrua në një miting të madh popullor, ku, përveç mijëra fshatarëve e qytetarëve të rrethit të Vlorës, morën pjesë edhe 360 delegatë nga krahinat e ndryshme të Shqipërisë dhe 26 deputetë të opozitës. Vrasja e Avniut u bë sinjal i luftës revolucionare kundër klikës tradhëtare të A. Zogut dhe feudalëve të tjerë gjakpirës.

Në këtë kohë Naun **Prifti mblodhi** popullin e krahinës së Libofshës, përgatiti kurorat dhe në

* Shiko shënimin Nr. 7

** Dokumenta e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941 Dok. Nr. 117 f. 125, Tiranë 1959.

krye të 50 vetave shkoi në Vlorë si delegat për të marrë pjesë në varrimin e udhëheqësit të tij të dashur — Avni Rustemit.

Më 2 maj, delegatët e krahinave të ndryshme, që kishin ardhur në Vlorë, i drejtuan Këshillit të lartë dy ultimatumë, por Qeveria reaktionare e Tiranës¹⁰ e bëri veshin të shurdhër dhe nuk mori asnjë masë. Në të katër anët e Shqipërisë u bënë mitingje dhe kuvende popullore, që kërkonin rrëzimin e qeverisë reaktionare të Tiranës me anë të kryengritjes së armatosur. Në Vlorë u bë plani i kryengritjes së armatosur.

Në këto çaste revolucionare, Nauni, në krye të një grupi të madh fshatarësh të armatosur, erdhi nga Vlora në Fier, ku mblodhi popullin, të cilit, në fjalimet e tij të zjarrta, i bëri thirrje të hidhej në luftë kundër qeverisë tradhëtare të Tiranës. Sipas planit të kryengritjes së armatosur, një kolonë prej 3000 vetësh ishte nisur nga Vlora në drejtim të Myzeqesë dhe një kolonë tjetër prej 1800 vetësh ishte nisur nga Përmeti. Në Fier Nauni bashkë me popullin e armatosur vrau një qen dhe e groposi përpara portës së Sami Bej Vrionit, duke i thirrur zonjës së tij: «Zonjë, dil e e qaje beun qen!». Kjo i bëri masat fshatare që të futeshin edhe më tepër në radhët e luftëtarëve.

Nauni, në krye të një grupi luftëtarësh, shkoi nga Fieri te kisha e Kozarës, ku, së bashku me forcat e tjera kryengritëse, luftoi kundër ushtrisë së Qeverisë së Tiranës, e cila u shpartallua. Duke marshuar për në Tiranë, Nauni me forcat e armatosura qëndroi në Lushnjë, ku përpara popullit që ishte grumbulluar për ditën e pazarit, mbajti një fjalim të zjarrtë kundër bejlerëve, të cilët i demaskoi për poshtërsitë dhe krimet e tyre.

Dy javë pas kryengritjes u çliruan me radhë të gjitha qytetet e Shqipërisë. Më 10 qershor forcën kryengritëse çliruan Tiranën. Kryengritja e Qershorit 1924, duke pasur përkrahjen e masave të gjëra të popullit, përmbysi qeverinë çifligare dhe klikën zogiste e solli në fuqi qeverinë e përkohëshme demokratike.

Më 19 qershor 1924 Qeveria e përkohëshme demokratike shpalli programin e saj, i cili parashikonte «çrrënjosjen e feudalizmit», vendosjen e demokracisë dhe masa të tjera ekonomike, shoqërore dhe kulturele.

Pas triumfit të Revolucionit të Qershorit Naunin e shohim të bëhet një nga aktivistët kryesorë të shoqërisë «Bashkimi». Ai tani filloi të merrej me çështjet e kësaj organizate, pasi ishte caktuar si përgjegjës në krahinën e Myzeqesë. Nauni shkonte sa në një vënd në tjetrin, ku u fliste fshatarëve për programin e qeverisë demokratike provizore.

Fitoria e Revolucionit demokratik ishte një hap përpara. Por kjo fitore u arrit në një kohë kur po fillonte stabilizimi i pjesëshëm e i përkohshëm i kapitalizmit, kur lëvizja revolucionare në Evropë e në Ballkan ishte në zbatim, kur fuqitë imperialiste dhe Qeveritë reaksionare të shteteve ballkanike ishin hedhur në sulm kundër lëvizjes punëtore dhe demokratike në vëndet e veta.* Ja si shkruante një vëzhgues i Kominternit ¹¹ më 20.VIII.1924: «Qeveria e re shqiptare më në krye Fan Nolin (peshkop ortodoks dhe luftëtar nacio-

* Historia e Shqipërisë (maket)për diskutim V IV f. 686

Handwritten: 17
23 128

nal) përfaqëson në çdo pikëpamje një progres të dukshëm»**.

Imperialistët dhe qeveritë reaksionare fqinje në Ballkan bënin presion të madh dhe përgatitje për të shtypur lëvizjen demokratike në Shqipëri me anë të klikave dhe tradhëtarëve të vëndit. Ja si shkruante gazeta «Drita»,¹² më 21 gusht 1924: «Qeveria duhet të marrë masat e duhura për çdo eventualitet dhe duhet të dijë që puna e suksesit të revolucionit nuk ish aq e zorshme sa është mbajtja e situatës dhe shfrytëzimi i kryengritjes në mënyrën e duhur. Ujët fle, po feudalët nuk flenë. Pra duhet të jemi edhe ne zgjuar»***.

Me gjithë sinjalizimet që pati nga poshtë, Qeveria demokratike e Fan Nolit nuk mori masat e duhura për të spastruar aparatit shtetëror nga elementët reaksionare dhe antidemokratike, të cilat bënin punë minuese. Në Ministrinë e Brëndëshme vazhdonte punën e tij sabotuese koloneli anglez Sterling, i sprovuar në luftën kundër boerëve në Afrikën Jugore. Në poste të tjera të rëndësishme u lanë elemente antidemokratike.

Qeveria u kufizua vetëm me sekuestrimin e pasurisë së çifligarëve të arratisur, por nuk ua dha fshatarëve tokën. Fshatarët filluan të kërkounin me këmbëngulje zbatimin e reformës agrare dhe përmirësimin e gjëndjes së tyre. Gazeta «Drita» e Gjirokastrës shkruante: «Çrrënjësja e feudalizmit është një konditë themelore për qytetërimin e Shqipërisë».

** Nga fondi i Kominternit mbi Shqipërinë, Arkivi Qëndror i Partisë.

*** A.Q. historik i RPSH-Dokumenta e materiale historike, f. 163.

Në të gjitha anët e Shqipërisë, nën drejtimin e «Bashkimit», u organizuan mbledhje e mitingje, ku u diskutua dhe u aprovua programi qeveritar. Kërkesa themelore e masave të popullit ishte zhdukja e plotë e sundimit politik dhe ekonomik të bejlerëve, çrrënjosja e feudalizmit.

Nauni, si aktivist i shquar i Bashkimit, shkoi në krahinën e Myzeqesë, ku, në fjalimet e tij, u fliste fshatarëve kundër bejlerëve dhe kundër shfrytëzimit. Kështu bujqit e 18 fshatrave të Myzeqesë kërkonin përkohësisht një përmirësim të pjesëshëm të gjëndjes së tyre duke dashur të zhdukin angarinë, të siguronin farën e tjera, por qeveria nuk mori masa në këtë drejtim. Për këtë shkak ajo filloi gradualisht ta humbiste përkrahjen e popullit, gjë që detyrohej ta pranonte edhe vetë Fan Noli, i cili, në një letër të drejtuar më vonë publicistit anglez S. Svajer, shkruante: «Unë ngjalla zemërimin e aristokracisë së tokës; duke mos mundur t'i nxjerr jashtë ata, humba mbështetjen e masave fshatare.»*

Vetëm Partia dhe Pushteti Popullor realizuan ëndërrën shekullore të fshatarit. Në letrën udhëzuese të K.Q. të P.K.SH. të datës 2 shtator 1946 në lidhje me shpalljen e Ligjit të Reformës agrare¹³ nga Këshilli antifashist nacional-çlirimtar thuhet kështu: «Kjo është një nga reformat më të mëdha në terrenin politik, ekonomik të vendit tonë, prandaj duhet të popullarizohet me të gjitha mjetet dhe zbatimi i saj të jetë si një rezultat i madh i lëvizjes nacional-çlirimtare, një rea-

* Historia e Shqipërisë (Maket për diskutim) V. IV f. 688-689.

litet me kuptimin e thellë politik, ekonomik e shoqëror për vendin tonë»**

Dëshira e revolucionarit Naun Prifti u vu në jetë vetëm në Pushtetin Popullor.

Partia dhe Pushteti Popullor i bëri zotër të tokës bujqërit myzeqarë, që dikur në rregjimin antipopullor i përbuznin duke i quajtur «lalë Myzeqeje». Duke u dhënë tapitë e tokave bujqve të Myzeqesë, më 25 nëndor 1945, shoku Enver Hoxha ka thënë: «Sot në këtë ditë mbyllet një herë e mirë një faqe e zezë dhe e trishtuar, plot vuajtje e mjerime, plot gjak e lot, një faqe e historisë së përpjekjeve shekullore të fshatarësisë për tokë dhe çelet një faqe e re e lumtur dhe e shkëlqyer e historisë së popullit tonë, një faqe ku dita ditës shkruhen fitore».***

Imperialistët që e kishin halë në sy qeverinë demokratike të 1924-ës, duke u mbështetur në këto dobësi dhe në reaksionin e brendshëm, organizuan komplotin kundër saj. Në tokën e Jugosllavisë dhe të Greqisë kishin filluar me kohë të organizoheshin e të pajiseshin me armë bandat e A. Zogut. Përveç kësaj, qeveria jugosllave përgatiti në shumë pika të kufirit edhe reparte të ushtrisë jugosllave dhe banda mercenarësh bjelllogardistë. Këta financoheshin nga qarqet monopoliste anglo-amerikane.

Më 10 dhjetor 1924, më shumë se 10.000 veta filluan veprimet ushtarake kundër shtetit shqiptar nga Veriu dhe nga Jugu. Qeveria e F. Nolit pro-

** PPSH — Dokumenta kryesore V. 1. f. 257, Tiranë 1960:

*** E. Hoxha, Gazeta «Bashkimi» Nr. 282 datë 26 nëndor 1945.

testoi kundër këtij agresioni, por Lidhja e Kombeve dhe Qeveritë imperialiste, që ishin organizatorët e këtij intervencioni antidemokratik, bënë veshin e shurdhër dhe ndihmuan agresorin.

Masat e popullit u revoltuan nga kjo ndërhyrje e poshtër dhe në mitingje e demonstrata u shprehën për mbrojtjen e vendit.

Në ato çaste kritike të Revolucionit të 1924-ës Naun Prifti ishte përsëri në vijën e parë të luftës kundër bandave mercenare të A. Zogut dhe ushtrive vrangeliste. Por qëndrimi i ngathët i Qeverisë dhe veprimtaria armiqësore e elementeve reaksionare në aparatit shtetëror dhe në ushtri i lejuan invazorët të përparonin me shpejtësi në tokën shqiptare. Më 17 dhjetor forcat kombëtare u thyen në betejën që u bë në Qenik (Dibër) dhe u tërhoqën. Intervencionistët po i afroheshin Tiranës. Në luftën që u bë në qafën e Priskës e në Shkallën e Tujanit, Nauni mori pjesë në luftime. Fuqitë mercenare të Zogut, më 24 dhjetor 1924, pushtuan Tiranën. Nauni me forca të tjera kombëtare u bëri një qendresë forcave mercenare në Kodrat e Rashbullit, por u tërhoq në Durrës, ku bashkë me shokët i hipi një vapori dhe shkoi në Vlorë prej nga emigroi në Itali.

Në Shqipëri u vendos regjimi diktatorial i satrapit Zog, i cili filloi të zhdukë e të burgosë elementet patriotë dhe përparimtarë. Shokët luftëtarë të Naunit u burgosën dhe u internuan. Komandanti zogist Taf Kaziu¹⁴ mblodhi popullin e Libofshës, e torturoi, e plaçkiti dhe shokun e ngushtë të Naunit, Zoi Ndrekon, e lidhi me litar dhe e vari te një plep me kokë poshtë. Të tillë xhelatë ishin mercenarët e A. Zogut, i cili e grabiti, dhe e masakroi popullin tonë për vjete me radhë.

A. Zogu ishte njeriu më i përshtatshëm i fa-
shizmit italian, i cili synonte ta kolonizonte ven-
din tonë me anë të kërbacit. Ja si thuhet në tele-
gramin e Musolinit të datës 25 tetor 1926 dërguar
konsullatës italiane në Shqipëri: «Vetëm duhet
ditur se Zogu është i vetëmi njeri i përshtatshëm
që me grusht mund të qeverisë Shqipërinë».*

Sa vuajtje, sa mjerime dhe sa të këqija kaloi
mbi kurriz populli shqiptar pas vendosjes së re-
gjimit diktatorial të satrapit Zog. Nauni asnjë
minutë nuk e hoqi nga mëndja popullin e vet,
por edhe në mërgim me gjithëse me shëndet të
keq, duke qënë optimist dhe i pamposhtur nga
vështirësitë, punoi për çlirimin dhe lumturinë e
tij.

Në të tilla kushte, në të tilla luftëra dhe
përpjekje revolucionare u rrit dhe u brumos bi-
ri i popullit të shumëvuajtur myzeqar Naun Gri-
gor Prifti. Ai qysh në vegjëli e ndjeu shtypjen,
varfërinë dhe mjerimin e fshatarëve myzeqarë të
robëruar nga bejlerët dhe feudalët, të cilët i
urrente dhe i luftonte për vdekje.

* Dokumenta e materiale historike nga lufta e popu-
llit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941, Nr. 231. f. 231.

JETA DHE VEPRIMTARIA E NAUN PRIFTIT NË MËRGIM

Me rikthimin e forcave të reaksionit në Shqipëri Nauni dhe shumë aktivistë të tjerë të «Bashkimit» u larguan nga atdheu, duke pasur gjithmonë besim të plotë në fitoren e sigurtë të popullit.

Ai, me gjithë se larg vendit, me zëmër ishte shumë afër popullit, të afërmve, miqve dhe shokëve të tij të luftës, të cilëve u shkruante vazhdimisht letra me pseudonimin Zhulie Petre. Ja si i shkruante nga Tiflisi një të afërmit të tij në Shqipëri, më 5 mars 1931:

«Ti nuk mund ta kuptosh se sa më gëzoi letra jote. Gëzimin tim mund ta marrij në mënd vetëm ai njeri, që ka qënë vetë në vende të huaja, larg të afërmve, far e fisave e shokëve të tij, siç jam unë sot».**

Nauni, me urrejtje të madhe kundër armiqve e xhelatëve të popullit, ndoqi me besim të plotë rrugën revolucionare marksiste-leniniste, atë rrugë të lavdishme të Leninit të madh, dhe të J. V. Stalinit — rrugë kjo që ishte bërë feneri ndriçonjës i proletariatit dhe i gjithë masave punonjë-

** A.Q.P. Fondi personal i Naun Priftit (shiko letërën Nr. 3 faqe 36).

se të botës. Edhe jashtë atdheut patriotët dhe revolucionarët shqiptarë e vazhduan luftën kundër bejlerëve dhe qeverisë reaksionare të Ahmet Zogut.

Në vitin 1925, në Vjenë, u organizua Komiteti Nacional Revolucionar shqiptar, i cili u quajt shkurtimisht KONARE.¹⁵ Në këtë organizatë përparimtare, krahas anëtarëve të ish shoqërisë «Bashkimi», bënë pjesë edhe emigrantë politikë të tjerë, nga të cilët disa që kishin tendenca reaksionare pas pak kohe u shkëputën dhe ndoqën një politikë antikombëtare dhe antidemokratikë.

Konare-ja, me anë të organit të saj «Liria Kombëtare»¹⁶ dhe të thirrjeve të ndryshme, demaskonte politikën terroriste, shtypjen dhe shfrytëzimin e regjimit të Zogut si dhe politikën grabitqare të imperialistëve, në radhë të parë të fashizmit italian. Ja si thuhet në shpalljen e saj të datës 5 maj 1925 në gjuhën frengjishte nxjerrë për të ndriçuar opinionin publik të botës: «Ndërhymja e huej, që i ktheu fuqinë Ahmet Begj Zogollit e shokvë të tij feodalë me mercenarët e tyne, asht tregue në shtypin e botës si një kryengritje që kanë bamë Shqiptarët. Por punët flasin ndryshe. Ky qe një pushtim serb, fjesnt një pushtim...» Më poshtë, në lidhje me fuqitë imperialiste të Evropës, thuhet, kështu: «Nu» banë asnjë çap për ta ndalur pushtimin e Shqipnisë, me gjithë që ishte një përdhunim i pacilësueshëm i së drejtës ndërkombëtare... Përfaqësuesi i Anglisë në Tiranë, Z. Eyres, s'pat lanë gur pa luejtun, prandaj që të ndalonte rrëzimin e Ahmet Begj Zogollit; gjithashtu bani ç'mund për me i sigurue të kthyemen në fuqi. Ky diplomat kishte arësytet e veta: se pak ditë mbasi hynë me triumf

bandat mercenare në kryeqytetin e Shqipnisë kompania Anglo-Persane mori monopolin e shfrytëzimit të vajgurit të Shqipnisë» *

Naun Prifti, që ishte një nga aktivistët e shquar të «Bashkimit», ishte anëtar i Konaresë. Ai, me porosi të kësaj organizate, në shtator të vitit 1925, u largua nga Italia për në Austri dhe bashkë me 18 veta të tjerë, nëpërmjet Berlinit, shkoi për të studjuar në Bashkimin Sovjetik, ku arriti më 8 tetor 1925. Këtu, si emigrant politik, u vu në dispozicion të MOPR-ës (Organizata Ndërkombëtare për ndihmë revolucionarëve) gjer në qershor të vitit 1926. Pas kësaj kohe, për shkak të shëndetit të dobët të tij, Nauni, në vitin 1926, dërgohet në Kaukazin Jugor, ku klima e butë ishte e përshtatëshme për shëndetin e tij jo të mirë. Me gjithë se ishte i dobët fizikisht, Nauni asnjë çast nuk iu shmang qëllimit për të cilin kishte ardhur, që të studjonte dhe t'i shërbente popullit dhe çështjes së Komunizmit. Kështu, me rekomandimin e Komitetit të Partisë komuniste (b) të Bashkimit Sovjetik për Transkaukazin, ai u dërgua të vazhdonte studimet në Universitetin Komunist të Transkaukazisë. Ja si thuhet në shkresën e Komitetit Krahinor të Transkaukazisë, datë 14.IX.1926: «Shoku N. Prifti është emigrant politik shqiptar, është dërguar nga Moska për të mësuar në U.K.T. * Provimin ai e dha në mënyrë të kënaqëshme. Dokumentat i kemi kërkuar dhe, pasi t'i kemi marrë, do t'ju përcjellim. Lutemi ta regjistroni sh. N. Prifti si student në U.K.T.»

* Arkivi Qëndror i Partisë F. Nr. 1 Komiteti Nacional revolucionar; Dosja Nr. 1.

* Universiteti Komunist i Transkaukazisë.

Kështu Nauni u regjistrua në Universitetin Komunist të Transkaukazisë në Tiflis, ku në fillim banonte në konvikt dhe pastaj në shtëpinë Nr. 14, Rruga «Çereteli». Ai kishte dëshirë të madhe për të mësuar dhe ishte i vetëmi ndër Shqipëtarët emigrantë politikë të asaj kohe, që arriti të mbarojë aspiranturën dhe të merrej me punë shkencore në sektorin e ekonomisë. Nauni ishte i zgjuar dhe studjor. Ai kishte mësuar mirë gjuhën greqishte dhe italishte dhe në Bashkimin Sovjetik, brënda një kohe relativisht të shkurtër, përvetësoi mirë gjuhën ruse, të cilën ai më vonë e përdorte lirisht dhe me shkathësi në punën e tij të gjerë propagandistike dhe pedagogjike, që zhvilloi në Gruzi, të cilën ai e donte dhe e admironte shumë.

Nauni në Universitet qysh në fillim mësonte mirë dhe dilte me përfundime të kënaqëshme, me gjithë vështirësitë dhe shëndetin e tij jo të mirë. Kështu p.sh. në lidhje me temën «Ekonomia politike e Napolonit I, që kishte shkruar ai në kursin e dytë, lektori Natadze, më 24 maj 1928, shkruante kështu: «Puna është bërë mirë» *

Është interesante të shohësh kartellën personale të studentit Naun Prifti, ku është dhënë karakteristika mësimore e tij. Ja si thuhet për të në kartellë: «Mbarëvajtja në lëndet shoqërore është e mirë, aktiviteti në punën e pavarur — i mirë, në punët e përgjithshme të grupit — i mirë, qëndrimi kundrejt punës — i ndërgjegjshëm, shkalla e përparimit gjatë semestrit — ka bërë përparim të madh etj». Nauni, si revolucionar internacionalist, nuk kufizohej vetëm me studimin, por

* A.Q.P. Fondi personal i Naun Priftit.

zhvillonte një aktivitet të gjerë shoqëror. Në 1927 ai, duke qënë student i kursit të parë, bëri lutje në organizatën e partisë të Universitetit komunist të Transkaukazisë për t'u pranuar si kandidat për anëtar të Partisë Komuniste (b) të B.S. Më 18 prill të po atij viti lutja e N. Priftit u shqyrtua në organizatën bazë të partisë, e cila vendosi «ta shtyjë lutjen për arësye se» nuk e njuh shokun». Pas 8 muajsh, më 24 janar 1928, lutja e tij për t'u pranuar kandidat partie shqyrtohet për të dytën herë. Tani ai kishte rekomandim nga Komiteti Qëndror i MOPR-ës në B.S. dhe nga pesë shokë partie. Në mbledhjen e përgjithëshme të komunistëve të Universitetit Komunist të Transkaukazisë, më 24 shkurt 1928, Nauni pranohet si kandidat për anëtar partie dhe, më 21 mars 1928, komisioni i pranimit të Komitetit të qytetit të Tiflisit e aprovoi pranimin e tij.

Por vuajtjet në të kaluarën, endjet nga një vënd në tjetrin dhe puna intensive ndikuan shumë në shëndetin e Naunit. Në vitin mësimor 1926-1927 në raportin mbi rezultatet e vizitës mjekësore të studentëve në U.K.T. thuhet kështu: «Ka nevojë për t'u kuruar me doemos në sanatoriumin e Abastumanit ose të Cemit, është tuberkuloz pulmonar i fazës së parë, tuberkuloz i gjendrave limfatike, anemi».

Drejtoria e Universitetit dhe organizata e partisë i kushtonin një vëmëndje të madhe N. Priftit si student i sëmurë. Për çdo vit ai dërgohej për kurim në Abastuman, por me gjithë këtë shëndeti i tij vinte gjithmonë duke u keqësuar dhe, më 22 shtator 1928, komisioni i vizitës mjekësore konstatoi se ai mund të punonte jo më tepër se 6

orë në ditë. Por Nauni asnjë çast nuk e pakësoi punën e tij, por përkundrazi e shtoi edhe më tepër. Ai ishte optimist dhe nga sëmundja që kishte nuk e humbi kurajën për asnjë çast. Në një letër që i shkruante, më 29.VI.1928, një shokut të tij, në Bashkimin Sovjetik, për t'i dhënë të kuptojë atij se fibroza që ai kishte nuk ishte ndonjë gjë me rëndësi në krahasim me diagnozën e vet, ja si thotë: «Vetë jam T.B.C., plevit i thatë, gjendrat tuberkulare të zmadhuara, anemi; si rrjedhim i kësaj shpesh kam marrje mendsh dhe zemër të dobët, edhe prapë elhamdytilahi them se jam mirë. Edhe po të më shohësh në fytyrë, vërtet që nuk mundem me thanun se jam i sëmundun, vetëm po të këndosh diagnozën edhe merr vesh vetë lajme të bukura. Me gjithë këto unë kam ardhur në këtë konkluzion: Pa qënë unë akord me vdekjen ajo nuk mundet me më marrun». Nauni, me gjithë sëmundjen e rëndë që, nga dita në ditë, po e shkruhe nga shëndeti, prapëprapë tregohej shumë entusiast dhe nuk u largua asnjë herë nga mësimi dhe nga puna e tij shoqërore, me gjithëse, më 22 shtator 1928, komisioni i vizitës mjekësore e kishte këshilluar që të mos punonte më tepër se 6 orë në ditë. Përveç mësimit ai, si komunist, bënte një punë të madhe shoqërore, ishte anëtar i Komitetit të agjitacionit dhe të komisionit revolucionar të Komitetit të qytetit të MOPR-ës. Dhe nga ana tjetër, me gjithë se ishte me mijëra kilometra larg shokëve shqiptarë, Nauni për asnjë çast nuk e largoi mëndjen nga çështja e lëvizjes komuniste në Shqipëri. Ai gjithmonë mendonte për popullin e tij, donte të mësonte dhe të kthehej në atdhe për të punuar për çështjen e çlirimit të popullit.

nga zgjedha feudalo-borgjeze. Sikundër dihet, Shqiptarët e emigruar në Bashkimin Sovjetik, qysh nga fundi i vitit 1927, bënë përpjekje për të organizuar një komision inisiator, i cili të kujdesej për lëvizjen komuniste në Shqipëri. Më në fund, më 25 gusht 1928, nga një mbledhje e përgjithëshme u organizua Grupi komunist shqiptar në Bashkimin Sovjetik.¹⁷ Në këtë grup, përveç elementeve të shëndosha revolucionare, kishin mundur të hynin edhe disa elemente megallomane, që më vonë e braktisën rrugën revolucionare rrugën e vështirësive dhe të sakrificave.

Naun Prifti ishte pranuar anëtar i grupit komunist shqiptar në Bashkimin Sovjetik qysh në vitin 1928. Ja si i ka shkruar një shokut nga Tiflisi më 3.XI.1928, kur Nauni ka marrë letrën dhe materialet e formimit të grupit komunist shqiptar në Bashkimin Sovjetik: «Lajmin e formimit të organizatës e prita me gëzim se, me gjithë që vonë — бед + shkelëm në vitin e katërt që rrojmë në Unionin Sovjetik, kështu që jo vetëm ish por edhe kish shkuar koha të organizohemi; mu në fund u organizuam edhe ne shqipot, prandaj edhe përshëndet iniciatorët edhe uroj suksese në përmbushjen e problemeve, që shtrohen përpara G.K.SH.» **

Nauni kishte një të kaluar patriotike dhe revolucionare të pastër, ishte i singertë dhe i vendosur gjer në vdekje për çështjen e popullit. Ai këtë e kishte treguar me prova në luftën dhe aktivitetin e tij patriotik revolucionar kundër fashizmit italian dhe kundër feudalëve e klikave tradhë-

* Sepse

** A.Q.P. Fondi: Grupi Komunist Shqiptar në B.S. Dosja Nr. 4

tare-gjakpirëse. Tradhëtari Tajar Zavalani,¹⁸ që më vonë e zbuloi fytyrën e tij të vërtetë prej armiku të popullit shqiptar, e luftonte Naunin me qëllime të caktuara, duke shpifur dhe akuzuar për të.

Kur Nauni lexon këto akuza të poshtra prej provokatori, ja me sa revoltim dhe indinjatë i shkruan një shokut në letrën me datë 8.XI.1928: «Nuk pretendoj të jem njeri i patëmeta, pse një gja të këtillë mund të bajë një ober-egoist ose idiot, vetëm që më vjen shumë keq që t'më ngjitin ose t'më ngjyenë me ngjyrë gati kontërrevolucionare. Pas mendjes time asht absurd t'më akuzojnë mue për simpathi * fashizmit, kur jo kush tjetër veç se unë kam ndënjun në burg prej tij... De moj pikë de. Nuk kam fjalë e nuk mund të gjej si me shkruaj kur kujtoj ngjarjet e shkueme e akuzat e sotme trazohen(волнуюсь)**»

Nauni lufton me vendosmëri për mbarëvajtjen e punës së grupit komunist shqiptar në Bashkimin Sovjetik, i cili nga mungesa e një drejtimi të shëndoshë kishte dobësi të theksuara. Elementet ambicioze, që ishin në vende drejtonjëse të grupit, nuk e informonin Naunin si anëtar të grupit për çështjet e ndryshme, por vepronin në mënyrë arbitrare. Në lidhje me disa vendime që ishin marrë me 5-7 korrik 1929, Nauni dënonte ashpër frymën e tarallëkut, arbitraritetin dhe tendencat e ambicjeve personale. Ai ishte parimor dhe i mbronte çështjet e drejta me vendosmëri.

* Në origjinal është: më sumbathi.

** A.Q.P. Fondi, grupi komunist shqiptar në B.S., Dosja «Naun Prifti».

Në vitin 1930 Nauni, për cilësitë e tij bolshe-
vike dhe për veprimtarinë e gjerë shoqërore, pra-
nohet si anëtar i Partisë Komuniste (b) të Bash-
kimit Sovjetik në organizatën e Tiflisit.

Nauni e mbaroi me sukses kursin 4-vjeçar në
Universitetin Komunist të Transkaukazisë. Ja si
thuhet për të në protokollin me datë 28.II.1930
të komisionit për vlerësimin akademik të studen-
tëve, që mbaruan Universitetin në vitin akade-
mik 1929-1930: «Gjatë kohës që ka qënë në Uni-
versitet ka pasur një përparim të madh dhe ka
fituar shprehi të rëndësishme për punë të pa-
varur në lëndet kryesore; ka pasur një mbarë-
vajtje plotësisht të kënaqëshme».

Pasi mbaroi Universitetin komunisti Naun
Prifti, më 3 prill 1930, u dërgua si punonjës shkencor
në Institutin e Kërkimeve shkencore të Komisionit të
planit të shtetit për Transkaukazinë. Ja si thuhet në
letrën më datë 3.IV.1930 dërguar nga Lisovski-
lektor i Universitetit Komunist të Transkaukazisë:
«U.K.T. me emrin e 26-ve nga ana e vet rekomandon
shokun **Naun Grigor Prifti**, që ka mbaruar Uni-
versitetin më 1930, plotësisht të përshtatshëm
për punën e kërkimeve shkencore». Më 20 maj
1930 aspiranti Naun Prifti në mbledhjen e përgjith-
shme të Institutit të kërkimeve ekonomike u zgjodh
si i plotfuqishëm i bashkimeve profesionale me të
drejtat e kryetarit të Komitetit lokal. Në verë të
këtij viti ai shkoi në Abastuman, ku qëndroi gjer
në fund të gushtit për të bërë një kurë të plotë
sipas këshillës së mjekëve. Pasi u kthye nga
sanatoriumi në mbledhjen e Institutit të Kërkimeve
ekonomike të datës 14.X.1930 Nauni dha raportin e
punës të bashkimeve profesionale. Në Institut ai
vazhdonte aspiranturën në sektorin e planifikimit.

Pa marrë parasysh shëndetin që gjithënjë vinte duke u keqësuar, Nauni zhvilloi një punë shoqërore të gjithanëshme, drejtoi rrethin politik dhe dha mësimë mbi ekonominë politike në Institutin e bonifikimeve dhe vaditjeve të Transkaukasisë. Qëndrimi, puna dhe veprimtaria shoqërore e tij vazhdojnë të jenë shëmbëllore edhe kur u bë aspirant. Ja si thuhet në karakteristikën e sekretarit të organizatës bazë të partisë të Institutit: «Shoku Naun Prifti është treguar një shok plotësisht i disiplinuar dhe i sprovuar nga pikëpamja politike. Gjatë kësaj kohë shoku Naun Prifti ka marrë pjesë aktive në të gjitha punët shoqërore dhe në punët e partisë të Institutit».

Sipas direktivave të Kominternit ishte e domosdoshme që qendra e lëvizjes komuniste shqiptare të ishte në Shqipëri, ku të punohej me masat për themelimin e partisë komuniste. Në këtë mënyrë grupi komunist shqiptar në Bashkimin Sovjetik, nga fundi i vitit 1930, u shpërnda dhe disa shokë si Ali Këlmendi ¹⁹ e të tjerë erdhën në Shqipëri.

Në këtë kohë imperializmi italian ishte futur thellë në ekonominë e vendit tonë. Varfëria, papunësia dhe mjerimi ishin përhapur kudo. Fashizmi italian synonte që ta kolonizonte Shqipërinë. Ja si shkruante gazeta «Liria Kombëtare» më 19 qershor 1931: «Në Myzeqe (Fier-Libofshë) kanë ardhur mjaft familje italjane dhe janë vendosur në çifligjet e shtetit. Kjo është avangarda e kollonëve italianë, që do të zaptojnë tërë Myzeqenë. Populli është zëmëruar pa masë kundër regjimit që u pruri në shtëpi kollonët e Musolinit». (Liria Kombëtare, viti VII, Nr. 144).

Naun Prifti, që kishte fituar një përgatitje të mirë marksiste-leniniste, kishte dëshirë të madhe të kthehej në atdheun e tij, ku të punonte për popullin punëtor e fshatar. Ja si i shkruante nipit të tij në Shqipëri në letrën më datën 5 mars 1931: «Unë kuptoj se me të mbaruar universitetin do të mundnja të kthehesha në Shqipëri, po nuk më doli siç kuptoja unë. Edhe kjo rrodhi jo se unë nuk dua që të kthehem në Shqipëri, por se janë të tjera shkaqe që më ndalojnë të vinj, që më zënë udhën shul-kryq e s'më lënë të vinj».*

Në shtator-tetor 1931 Nauni me leje shkoi në Moskë për të rregulluar ardhjen e tij në Shqipëri, por nuk u lejua të shkonte për arsye të shëndetit të tij të keq. Pas dy jave ai u kthye përsëri në Institut për të kryer aspiranturën. Më 13 shkurt 1932 Sekretariati i Komitetit të Partisë Komuniste (b) të Gjeorgjisë mori një vendim «Mbi nxjerrjen e kuadrove të propagandistëve për njësitet e ushtrisë së kuqe të Garnizonit të Tbilisit». Në listën e propagandistëve të aprovuar gjendet edhe emri i Naun Priftit. Në këtë vendim të Komitetit thuhet: «Puna në ushtri e shokëve të caktuar si propagandistë të quhet si punë kryesore e partisë për ta; ata nuk mund të mobilizohen për punë tjetër pa pëlqimin e Drejtorisë Politike.** Siç shihet, kjo ishte një punë me përgjegjësi dhe besim të madh, të cilën Nauni, si internacionalist, e kreu me ndërgjegje në mënyrë të shkëlqyer.

Në Institut Nauni punoi aktivisht edhe në lëmin shkencor. Në maj 1932 ai mbaroi aspirantu-

* A.Q.P. Fondi personal i Naun Priftit (shiko letrën Nr. 8 faqe 36).

** A.Q.P. Fondi personal i Naun Priftit

rën. Pas kësaj kohe Nauni zhvilloi punë shkencore, mbante leksione mbi ekonominë politike dhe filloi të kryejë funksione drejtuese në Institucionet e larta arësimore të Gjeorgjisë. Nauni ishte i dashur dhe i thjeshtë me pedagogët dhe studentët në Gruzi, të cilët dhe sot e kujtojnë me respekt këtë revolucionar dhe shkencëtar komunist shqiptar. Ja si thuhet në artikullin me titull «Faqe të shkëlqyera nga jeta e veprimtaria e patriotit revolucionar shqiptar Naun Prifti në Gruzi» shkruar në gazetën «Zarja Vostoka». Nr. 45 datë 23 shkurt 1960: «Punonjësit e Gruzisë do ta ruajnë për gjithnjë kujtimin e ndritur të patriotit revolucionar të lavdishëm shqiptar». Në Prill të vitit 1933 Nauni caktohet shef për anën mësimore në Institutin e ndërlidhjes të Transkaukazisë, ku edhe këtu u tregua një punonjës i mirë. Më vonë caktohet zëvendës drejtor për anën mësimore i Institutit të inxhenjerëve të ndërlidhjes elektrike të Transkaukazisë. Në urdhërin e Institutit Nr. 112, datë 20 shtator 1933, thuhet se zëvendës drejtori për anën mësimore, shoku Naun Grigor Prifti, do të vazhdojë përmbushjen e detyrave të veta, dhe me qënë se Drejtori largohet, detyrat e tij i ngarkohen Naun Grigor Priftit». Shumë urdhëra dhe shkresa janë firmuar nga ai.

Në këtë Institut ai drejtonte katedrën për lëndët politiko-shoqërore, ku ka zhvilluar një punë të madhe.

Tre-katër muajt e fundit të jetës së tij, Naun Prifti, që ishte i sëmurë rëndë, i kaloi në sanatoriumin «Shtëpia e Kuqe» në Gulripshi (jo shumë

larg nga Suhumi). Për Naunin u kujdesën shumë institucioni ku ai punonte, Komiteti Qëndror i MOPR-ës, miqtë, shokët dhe të afërmit e tij.

Më 10 maj 1934, Naun Grigor Prifti vdiq në sanatoriumin «Shtëpia e Kuqe» në Gulripshi. Lajmi i vdekjes së tij, që u përhap me anë të gazetave «Komunist» dhe «Zarja Vostoka», hidhëroi thellë popullin dhe të gjithë ata, që e njihnin dhe që shoqëroheshin me të. Ja si thuhet në gazetën «Komunist», organ i K.Q. të P.K. të Gjeorgjisë më 17 maj 1934: «Presidiumi i KQ të MOPR-ës të Gjeorgjigjë njofton gjithë anëtarët e MOPR-ës dhe emigrantët politikë se më 10 maj në sanatoriumin e Gulripshit vdiq para kohe emigranti politik, aktivisti i MOPR-ës shoku Naun Prifti». Po ashtu në gazetën «Zarja Vostoka» është botuar ky lajmërim në kohën e funeralit: «Kombinati mësimor i Transkaukasisë për ndërlihdjen njofton mbi vdekjen e ish zëvendës drejtorit për anën mësimore Naun Grigor Prifti në Gulripshi, më 10 maj 1934».

Revolucionari komunist Naun Prifti vdiq në moshë të re-akoma nuk i kishte mbushur plotësisht të 36 vjeçët. Ai nuk arriti që diturinë që mori ta vinte gjerësisht në shërbim të popullit të tij. Nauni nuk qe vetëm revolucionar, por ishte edhe një propagandist i fortë dhe një shkencëtar që kishte perspektiva të mëdha.

Kujtimi i revolucionarit myzeqar komunist Naun Grigor Prifti (Doko) do të mbetet i gjallë për ne dhe për brezat e ardhshëm. Në Gruzi Nauni

kishte fituar simpati të madhe. Ja si shkruante gazeta «Zarja Vostoka» më 23 shkurt të vitit 1960: «Vjetët nuk i kanë shlyer kujtimet për birin besnik të popullit shqiptar, i cili ndërton tani në tokën e tij socializmin dhe një jetë gazmore të ndritur, së cilës ja kushtoi veten Naun Prifti».

II.

PJESË TË NXJERRA NGA LETRA TË NAUN PRIFTIT

Shënim: Në letrat e tij, që ka shkruar në gjuhë shqipe, ka përdorur edhe fjalë e shprehje në gjuhë ruse, të cilat ne i kemi lënë ashtu siç janë pa i ndrequr nga ana gramatikore, por i kemi përkthyer shqip në fund të çdo faqeje.

Nr. 1

NGA LETRA E NAUN PRIFTIT DATË 3. XI.1928,
KU SHPREH GËZIMIN E TIJ TË MADH PËR FORMIMIN
E GRUPIT KOMUNIST SHQIPTAR NË
BASHKIMIN SOVJETIK.

Tiflis 3.X.1928

I DASHUR SHOK!

Letrën me anën e së cilës më lajmëronje formimin e organizatës «Grupi Komunist Shqiptar» si edhe pranimin t'im anëtar të këtij grupi, mbyllur pastaj me 'të edhe: a) një kopje të statutit të G.K.SH.», b) një kopje të «tezave mbi gjëndjen në Shqipëri dhe problemet tona, c) një kopje të «protokollit të mbledhjes së «Grupit Komunist Shqiptar» mbi zgjedhjet e K.P.*, edhe ç) një kopje të «instrukcionit përfaqësorjësve të G.K.SH. pranë K.Ç.N.** i mora — Lajmin e formimit të

* Komisioni i Përgjithshëm.

** Komiteti çlirimtar nacional (shiko «shënimet» pika Nr. 7).

organizatës e prita me gëzim, se, me gjithë që vonë — ведь* shkelëm në vitin e katërt, që rrojmë në Unionin Sovjetik,** kështu që jo vetëm ish po edhe kish shkuar koha të organizohemi, — mu në fund u organizuam edhe në Shqipot, prandaj edhe përshëndet iniciatorët edhe uroj sukses në përmbushjen e problemeve që i shtrohen përpara G.K.SH. ***

Të fala

Naun Prifti

Botohet sipas origjinalit që ndodhet në A.Q.P. Fondi: Grupi Komunist Shqipëtar në Bashkimin Sovjetik, Dosja «Naun Prifti».

* Sepse.

** Bashkimi Sovjetik.

*** Nga fundi janë hequr 6 reshta.

Nr. 2

PJESË NGA LETRA E NAUN PRIFTIT DATË 6.II.1929,
KU NJOFTON PËR KRYERJEN E DISA PËRKTHI-
MEVE DHE PËR MOSMARRJEN E LAJMEVE
NGA SHQIPËRIA.

Tifilis 6/II/1929.

I DASHUR SHOK!

III. Përkthim Broshure. Qi kur erdhëm në
Unionin Sovjetik,** kam përkthyer a)
Задачи коммунистической молодёжи *** Fjalë e
Leninit në Kuvendin III Panrus të P.K.C.M.****
b- Konstitucionin e Sovjetëve edhe c- Panuklla
d.m.th. zgjebja religjioze. Q'at'here këto s'i kam
parë më që t'i kreh pak e t'i pregatit për shtyp. .

IV. Lajme e gazeta shqiptare e nga Shqipëria.
Gazeta shqipe marr L.K. dhe B.K.***** po edhe

* Mungojnë 61 rreshta.

** Në Bashkimin Sovjetik.

*** Detyrat e rinisë Komuniste.

**** Kongresi III i Bashkimit Komunist të Rinisë të
Rusisë.

***** Mungojnë 10 rreshta.

***** «Liria Kombëtare» edhe «Bashkimi Kombë-
tar».

këto shumë rrallë — nga ndonjë herë në krye të muajit nuk marr asnjë numur. Nga Shqipëria është e ditur që s'marr gazeta se s'kam kush të m'i dërgojë q'atej. Gjithashtu edhe lajme me anë letrash nga Shqipëria s'kam. Vjet nipit t'im i pata lypur të më përmbushte një anketë me pyetjet q'i bënjnë unë mbi zhvillimin ekonomik të Shqipërisë. Ai pas 4-5 muajsh më shkruan se ma mbushi dëshirën — anketën q'i lypnija ma përmbushi e ma dërgoi, (më kish dërguar bashkë me 'të edhe fotografinë e s'ëmës, motrës t'ime) edhe më qëronte përse nuk iu përgjegja. Mua një gjë e këtillë s'më ra në dorë. Duket se censura shqiptare s'e ka lënë. Tashti kam 4 muaj që s'kam marrë letër nga Shqipëria edhe jam mjaft merak, sidomos që me t'u proklamuar A.Z. * mbret, shkrova një letër mjaft të gjatë.....

V. Artikulli yt: Indipendence shqiptare. Artikullin në fjalë e këndova dy herë: një herë kur e mora gazetën afro dy muaj të shkuara edhe një herë përpara se të shkruaj këto radhë. Artikulli mua më pëlqeu, bën në 'të analizë social-ekonomike të mirë. Nga ana ime mua më duket sikur politika separative — diferenciale e Turqisë ndaj krahinave të ndryshme *** e ndaj popullit shqiptar nuk theksohet me qartësinë e duhur. E përmënd këtë, jo se nuk e përmënd, por nuk tregon shkakun e një politike të tillë qartas, konsekuencat. ...
..... ***

* Ahmet Zogu.

** në tekst është ndaj krahinat e ndryshme

*** janë hequr 47 rreshta.

VIII. Të ndryshme. A. Nga shëndeti jam, siç të thuash, as mirë as keq. Gllandullat lenfatike, që janë barometër i mëlçive, zunë prapë e po mërriten.....*

Naun Prifti

Botohet sipas origjinalit që ndodhet në A.Q.P.
Fondi: Grupi Komunist Shqipëtar në Bashkimin
Sovjetik. Dosja: Naun Prifti.

* janë hequr pesë reshta.

PJESË NGA LETRA E NAUN PRIFTIT DATE
14.V.1929, KU ÇFAQ GËZIMIN PËR NJOHJEN E
GRUPIT NGA KOMINTERNI DHE KËRKON
VËRTETIM PËR ANËTARËSINË E TIJ
NË KËTË GRUP.

Tiflis 14.V.1929

I DASHUR SHOK!

. , , , , , *
Nga shëndeti jam si edhe përpara. Gllandu-
llat lymfatike m'u rritën simbas zakonit. Медо
смотр * para të cilit shkova, ka 5-6 ditë, më për-
para theksoi nevojën e një kure 1 1/2 muaj në
Abastuman, po të shohim a do më dërgojnë. Më
25. V. shkurtohen studimet e më 1.VI. nisem në
punë praktike. Kam kërkuar të më dërgojnë në
Batum në punë se është buzë deti. Me studimet
nuk ja çoj keq. Муа устраивает *** sikur mbledhja
e përgjithëshme e grupit të bëhet prej 20 korrik
e tutje. At'here unë mund të vij. U gëzova që sta-
tuti i Grupit следовательно **** edhe grupi vetë
u pranua definitivisht prej K.I. ***** Dërgomë,

* Mungojnë 51 reshta.

** Vizita mjekësore.

*** më bëhet më mirë.

**** rrjedhimisht.

***** Интернационаlia Komuniste.

të lutem, statutin si edhe tezat në kanë ndryshim nga të parat. Kush u kërkoi spravkë* për mua, Ком. бюро ячек** tonë, apo nonjë organizatë tjetër. Ç'i shkuat! Shumë të lutem të më dërgosh sa të jetë e mundur më shpejt spravkë, që jam anëtar i grupit, ngjitur pastaj edhe vipiska*** të protokollit ose ku e di unë të K.I. që grupi është i njoftur prej tij, se dua t'a paraqit në ТК**** Kaq për këtë herë. Hajnos i dërgova mjaft gazeta shqipe për të gjithë të Leningradit. Këndojini e shqyhuni gazi sidomos për «lotët» që derdhi Buharini²⁰ në Полт-бю-ро*****

Të falura komuniste yti
Naun Prifti

Përgjigjen dërgoje me aeropostë që të më gjejë këtu.

Botohet sipas origjinalit që ndodhet në A.Q.P. Fondi. Grupi Komunist Shqiptar në Bashkimin Sovjetik, Dosje: N. Prifti.

* Vërtetim.

** byroja komuniste e celulës

*** pjesë e nxjerrë nga një tekst

**** Komitet i Tiflisit.

***** në byronë Politike.

LETRA E NAUN PRIFTIT QË JA KA DËRGUAR NGA
TIFLISI NJË TË AFËRMI TË TIJ NË SHQIPËRI
MË 5 MARS 1931.

Tiflis 5.III.1931.

Ti nuk mund t'a kuptosh se sa më gëzoi letr'e jote. Gëzimin timin mund t'a marrij me mënd vetëm ai njeri, që ka qënë vetë në vende të huaja, larg të afërmve, far e fisave e shokëve të tij, siç jam unë sot.

Që të mos zgjatem më, të shkruaj gjëndjen t'ime. Është sot plot një mot-mot që mbarova universitetin, ku studjova 4 vjetë. Unë kuptonja se me të mbaruar universitetin do mundnja të kthehesha në Shqipëri, po nuk doli siç kuptonja unë. Edhe kjo rrodhi jo se unë nuk dua që të kthehem në Shqipëri, po se janë të tjera shkaqe që më ndalojnë të vinj, që më zënë udhën shul-kryq e s'më lenë të vinj. Nuk do t'i spiejoj ç'janë këto shkaqe, se nuk e shoh të volitëshme, vetëm që të mos kuptohem keq, shtoj që si shkak ndalimi për t'u kthyer aty nuk duhet kuptuar gruaja d.m.th që jam martuar e nuk më le gruaja që të vij, se unë akoma nuk jam martuar. Me qënë se erdhi fjala tek gruaja, do të shkruaj pak radhë mbi këtë çështje. Motrat, kushërinjtë, përgjithsisht far e fisat e mij e shokët janë hidhëruar që e fejuara ime u martua. Kjo kuptohet vetëve-

tiu mbasi vendi ynë, si i mbetur pas botës të pakën 300 vjet, vazhdon të ushqehet me tradicione (adete) primitive patriarkale, quan turp të madh që të martohet gruaja ose e fejuara kur burri është gjallë, po në vënd të huaj. Nuk është çudi që ata e quajnë si armik Thanas Gjërmenin, që martoi çupën. Nuk është çudi që edhe mua më numurojnë si djal-prodig, harram, namusës e ku e di unë. Unë, si bir i atij vendi, i di të gjitha këto edhe prandaj më vjen shumë keq kur kujtoj se sa pas ka mbetur ai vend. Kurr gjë të keqe s'bëri Gjërmeni, që martoi çupën, aq më pak e quaj unë vehten të ofenduar nga kjo ngjarje. Edhe për pakë desh të zgjatesha mbi temë sociologjike. E lemë mënjane këtë çështje aq më tepër se ti nuk mund të më kuptosh mua nga që s'ke aqë shkollë sa duhet për të kuptuar të këtilla çështje.

Kështu pra, me qënë se s'mund të vij menjëherë si mbarova universitetin, mbeta këtu gjer sa të gjej rast e konditat e duhura për të ardhur. Juve ju intereson me ç'punë merrem. Ja pra, do t'a spiegoj, punoj (natyrisht jo punë fizike, po intelektuale) në dy vende: në Institutin e esploreacioneve ekonomike edhe në institutin e ingjenerisë. Në këtë të fundit, ku studjojnë të bëhen myendizëre (ingjinerë) jap mësimë mbi ekonominë sociale, në institutin e parë punoj si shkençëtar. Ti vetë s'i kupton dot këto se në Shqipëri më lart se gjimnaze s'ka shkolla të tjera, po mund t'i shpjegojë Jorgji. Qyteti Tiflis, ku jam unë, është kryeqyteti i shtetit Gjeorgjija edhe ka afro 500.000 ndenjës. Shqipëria e tërë ka gjithësejt 1 milion. Kaq mbi vehten time. Tashti kthehem aty. Si jeni juve aty të gjithë me shëndet: ime motër, pleqët, Jorgji, Ndreka, me gratë e fëmijët,

ti vetë e Urania me Konxhen? Ku e dhatë Uraninë? A është fatbardhë? Me se merret Jorgji? Shkruamë mbi të gjitha këto pyetje. Gjithashtu shkruamë ç'bëjnë nga Kozi e nga Pina. Sa keq që asnjera nga motrat e mija s'di të shkruajë.

Thuaju të gjithëve që unë jam fare mirë edhe kurrkush të mos bëhet merak për mua. S'kam më ç'të shkruaj, fotografinë t'ime kam për ta dërguar herën tjetër. Të falura me mall të gjithëve.

Të përqafoj. Yt Ungj.

Girulio Prete*

P.S. Mos përdor fjalët zot, perëndi se i kam zët.

Botohet sipas origjinalit që ndodhet në A.Q.P. Fondi personal i Naun Priftit.

* Pseudonimi i Naun Priftit.

III.

KUJTIME DHE SHKRIME PËR NAUN PRIFTIN

ARTIKULL I GAZETËS «LIRIA KOMBËTARE MBI VDEKJEN E NAUN PRIFTIT

* * *

NAUN PRIFTI

Me hidhërim të madh revolucionarët shqiptarë mësuan që vdiq, ca kohë të shkuara, shoku ynë Naun Prifti.

Naun Prifti ka qënë një nga të pakët intelektualë të Myzeqesë që kanë luftuar bejlerët e atjeshëm. Dhe jo vetëm që lëftonte bejlerët Nauni, me çdo mënyrë, me dyfek në dorë, me penë, me gojë, po përpiquej të organizonte bujqit, gjë që ka rëndësi të madhe për luftën revolucionare që bëjmë ne.

Bejlerët nuk e shihnin dot me sy këtë «lale» kryengritës dhe donin ta lanin hallin me të, ashtu si kanë zakon të lajnë hallin me bujqt' e Myzeqesë, me anë të qehjallarëve, do me thënë duke i vrarë prapa krahëve.

Shoku Naun Prifti vdiq në vërsën 31 vjetsh.²¹ Në lëvizjen revolucionare ka marrë pjesë që më

1920 kundër okupatës italiane. Ahere italianët e zunë Naunin dhe e futnë në burg, ku e mbajtën 11 muaj. Në luftën e Vlorës Naun Prifti mori pjesë me dyfek në dorë në Bunavi, ku qe fronti më i rrezikshëm. Si u fitua lufta — me ndihmën e punëtorisë italiane — kundër zaptonjësve italianë prej fshatarëve trima të Labërisë, Naun Prifti nisi luftën në Myzeqe kundër armikut të brëndshëm, armiqtve kllase bejlerëve. Më 1923 Nauni hyri në shoqërinë e Avni Rustemit, Bashkimin, dhe mori pjesë aktive në revolucionin e Qershorit, në grupin e Bashkimit. Si kryetar i degës së Bashkimit në Libofshë të Myzeqesë, Nauni zhvilloi një aktivitet të madh dhe fitoi shumë simpati në «lalët» vëllezërit e tij dhe urrejtjen për vdekje të bejlerëve, gjë për të cilën mburrej me të drejtë. Gjithashtu Nauni lëftoi kundër intervencionit jugosllav dhe kundër kundërvolucionit të brëndëshëm në Shën-Ndre* 1924 dhe pas «triumfit të Legalitetit»²² iku me shokët e tjerë për në Itali. Në mërgim Nauni nuk e humbi kohën duke lojtur kumar dhe duke bërë pallavra nëpër kafenetë, po iu vu mësimit dhe mori një edukatë revolucionare të shëndoshë.

Nauni vdiq nga një sëmundje e vjetër, që mori në burgun italian. Kështu iku një revolucionar trim dhe një shok i dashur dhe i singërtë. Ne shokët e vjetër të Naun Priftit përqëndrohemi që jetën e tij do ta kemi shëmbëll për çdo revolucionar shqiptar. Vëndin e Naun Priftit do ta zënë dhjetra revolucionarë të tjerë, bij të fshatarëve dhe të punëtorëve. Bejlerët e Myzeqesë le të

* në Dhjetor.

mos gëzohen. Revolucinarët nuk shuhen. Për kundërazi po shtohen dhe do të shtohen ditë për ditë. Dhe dita e hesapeve po afrohet.

Francë-Shën-Ndrre 1934

Nxjerrë nga gazeta «Liria Kombëtare» Nr. 179
dt. 26 shkurt 1935.

Biblioteka Kombëtare e R.P.Sh. — Tiranë.

KUJTIME TE KOLI GEGËS, BASHKËLUFTËTAR I NAUN PRIFTIT

Në vitin 1924 unë isha punëtor në fermën e Lushnjës. Në muajin maj të këtij viti shkova me leje në shtëpi, mbasi kisha nënën shumë të sëmurë dhe që vdiq. Atë ditë kur u bë varrimi i nënës time fshati u lajmërua që ditën e nesërme të gjithë fshatarët të mblidheshin tek Kisha e Libofshës. Kështu që ditën e nesërme u mblodhën aty më tepër se 300-400 veta.

Në këtë mbledhje të gjerë Naun Prifti mbajti një fjalim mbi vrasjen e poshtër të Avni Rustemit nga kriminelin Ahmet Zogu. Për varrimin e patriotit demokrat Avni Rustemi me inisiativën e Naunit ishin përgatitur kurora të shumta, të cilat i shpunë në Vlorë rreth 50 veta me Naunin në krye. Midis këtyre isha dhe unë. Me të arritur në Vlorë, bashkë me popullin e shumtë, shkuan edhe ne dhe kurorat i vendosëm mbi varrin e tij.

Në këtë kohë kudo urrenin klikat tradhëtare, që ishin në fuqi dhe filloi një lëvizje e gjerë e armatosur për të rrëzuar këta shtypës të popullit. Në Vlorë neve na thanë se do të nisemi të armatosur drejt Tiranës bashkë me forca të tjera kryengritëse të armatosura. Ne që na bashkuan me të tjerë u bëmë 150 veta dhe si komandaat kishim Naunin. Kështu, së bashku me fuqitë e

tjera kryengritëse, ne u nisëm nga Vlora përmes Fierit dhe erdhëm në bregun e lumit Seman drejt Libofshës. Me qënë se kishin ardhur fuqitë e Qeverisë reaksionare të Tiranës, mbas një përpjekje të vogël, ne u tërhoqëm anës së lumit. Nauni me shokët e tij, që kishte, shkoi anës së lumit gjer sa arrijti te Ura e Kuçit. Aty ne u bashkuam me ushtrinë kryengritëse të Përmetit, që erdhi nga Berati. Në bashkëpunim me to u bë plani për të sulmuar fuqitë reaksionare, që kishin ardhur nga Tirana. Unë u ngjita në një kodër, ku ishte Nauni, mbasi i çova paguren e ujit.

Në mbrëmje, porsa u errsua, neve na u dha urdhëri për t'i sulmuar armiqtë, që ishin në kodrat e Kozares. Mbas 4-5 orësh luftë ushtria e armikut u thye dhe ne marshuam për në Lushnjë e që këndej për në Tiranë.

Nauni në Tiranë u muar më tepër me punë të organizatës «Bashkimi», kurse unë qëndrova në ushtri.

Nga fundi i vitit 1924 satrapi Ahmet Zogu me bashibuzukët e tij dhe me ndihmën e Qeverisë shoviniste serbe filloi sulmin kundër ushtrive tona. Ne këto forca bashibuzuke të Zogut i pritëm me luftë në Qafë të Priskës. Këtu erdhi dhe Nauni me një grup djemsh dhe i shkoi në ndihmë Riza Cerovës.

Në Qafën e Priskës ushtria jonë luftoi kundër forcave reaksionare, por pas 24 orësh luftime ne u detyruam të tërhiqemi. Nauni mua, që isha plagosur, më hipi në një kalë dhe më shtroi në spital të Tiranës, mirëpo pas dy ditësh ushtria reaksionare e A. Zogut hyri në Tiranë dhe mua më muarën në një karrocë dhe më prunë në Durrës, ku më hipën në një anije, që kishte më

se 30 veta. Nauni tregonte një kujdes të veçantë për njerëzit. Ai më zbriti mua në Dajlan të Karavastasë, kurse vetë iku në Vlorë.

Nauni ishte njeri i thjeshtë, trim, i patrembur dhe urrente bejlerët dhe shtypësit e popullit. Ai u largua nga vëndi i tij, por sado larg që ishte, e kishte në zëmër njerzit dhe shokët e tij.

Ne kujtimin e Naunit do ta ruajmë gjithmonë në zëmrat tona dhe do t'ua tregojmë cilësitë e tij të larta bijve dhe bijave tona, që t'i ruajnë fitoret e revolucionit popullor dhe që të mësojnë e të punojnë për ndërtimin e socializmit e të komunizmit në vëndin tonë.

A.Q.P. Kujtime të Koli Gegës për N. Priftin,
Fondi personal Naum Prifti.

NGA KUJTIMET E MARKO PRIFTIT
— BASHKËFSHATAR I NAUN PRIFTIT.

.....«Unë Naun Priftin e kam njohur mirë. Megjithëse gjëndja ekonomike e tij ishte jo e mirë, zbatuar edhe me rroba të grisura, por nga vullneti i tij i lart, ai asnjë herë nuk i ndërpreu mësimet. Por ai me ndihmën e mësuesit të tij Jovan Nrekos vazhdoi studimet e mesme. Me të mbaruar studimet, në vitin 1919, Nauni u caktua mësues në katundin Zharrnec të Lushnjës. Po këtë vit ai u arrestua nga karabineria italiane dhe u internua në katundin Babicë të Vlorës dhe, pastaj, po në atë vit e çuan në Itali, ku pas një viti u lirua nga burgju dhe u kthye në Shqipëri.

Më kujtohet mirë, kur e shoqëruan nga Zharrneci për në Babicë, kaloi përmes fshatit tonë me duar lidhur, por ishte plot guxim dhe i patrembur. Më nderoi me kokë dhe më dha shënjen që të njoftonja xhaxhanë e tij Kozi Dokon. Në këtë kohë, ky ishte i shëndoshë dhe i pashëm, por i mvrejtur dhe më fytyrë të ashpër, që shprehte urrejtje karshi atyre, që e kishin lidhur. Kur u kthye nga internimi më kujtohet mirë se fshati ynë doli e priti dhe u përshëndet me të. Ndërmjet bisedave, mbaj mënd këtë fjalë, që ai tha: «asgjë nuk fitohet kot duke ndenjtur, por duhet punuar dhe luftuar armiku...»

Në prill të vitit 1924, kur u vra Avni Rustemi, fshati ynë gra e burra, u mbloodhëm në oborrin e kishës, ku përgatitëm e nisëm kurorat për varrimin e Avniut *. Bashkë me këtë u nis një grup njerzësh prej fshatit tonë, gjithashtu edhe nga fshatrat e tjera të armatosur që në vënd. Këto grupe nuk u kthyen më, por shkuan drejt që nga Vlora për rrëzimin e Qeverisë reaksionare të Tiranës.

A. Q. P. Kujtime të Marko Priftit për Naun Priftin, Fondi personal: Naun Prifti.

* Avni Rustemi.

NGA KUJTIMET E THOMA NDREKOS — BASHKËMOSHATAR I NAUN PRIFTIT

.....Unë me Naunin kam qënë në një klasë dhe, pasi mbaruam shkollën fillore, unë qëndrova pranë shtëpisë, kurse Nauni vazhdoi edhe 3-4 vjetë të tjera në Manastir të Ardenicës. Që këndej Nauni shkoi në shkollën e Beratit dhe një vjet më vonë në shkollën e Elbasanit.

Në vjetin 1919 Nauni u emërua mësues në katundin Zharrnecë të Lushnjës. Këtu ai filloi propagandën kundër imperialistëve italianë dhe filloi që të grumbullonte armë; për këtë italianët e arrestuan dhe e burgosën.

Që në moshë të vogël Nauni ishte i zgjuar dhe shumë i kujdesëshëm për mësimet.

Nauni, pasi erdhi nga internimi, unë, si shok, që e kisha dhe si fshatar vajta e tokava. Atë ditë që ai erdhi u mblodh i tërë fshati dhe vajtëm e takuam. Më kujtohet se me sa urrejtje të madhe fliste kundër pushtonjësve italianë.

Pas dy muajve që u kthye nga internimi mblodhi një grup njerëzish dhe shkoi në luftë kundër Italianëve në Vlorë, ku me 'të ka qënë dhe kushëriri i em Zoi Ndreko. Pasi u çlirua Vlorë, Nauni shkoi mësues në Gradisht. Në vjetin 1924, në muajin prill, Nauni mblodhi një grup njerëzish dhe me kurora u nis për në Vlorë për

varrimin e Avni Rustemit.* Nga Vlora ai së bashku me shokët dhe me kryengritësit e tjerë shkoi për të çliruar Tiranën nga zogistët.

Gjatë kohës së Qeverisë së Fan Nolit ai erdhi vetëm një herë tek ne, mblodhi fshatin, punoi proklammatën e Qeverisë së Fan Nolit. Fjalimin e tij e mbylli me këtë thirrje: «Rroftë opinga dhe poshtë këpuca»! Populli ynë në fshat dhe në tërë Myzeqenë e donte Naunin me gjithë shpirt, sepse ai fliste me dashuri të madhe për vegjëlinë. Përkundrazi bejlerët, si Mustafa Bej Vokopolën e të tjerë gjakpërës, Nauni i urrente për vdekje. Ai në Fier foli kundër Pashajt. Më vonë Pashaj i Fierit, kur u vendos qeveria reaksionare e Zogut, në fjalimin që mbajti në Fier tha: «Deri sot nuk ka pasë zot në ne që të trokasë në sarajet e Pashajt të Ferit, kurse Nauni i Libofshës trokiti, por ta dijë mirë se Shqipërinë nuk do ta shohë më me sy».....

A.Q.P. Kujtime të Thoma Ndrekos për Naun Priftin, Fondi personal «Naun Prifti».

* Shiko shënimin Nr. 5.

NGA KUJTIMET E JORGJI XOXES — ISH NXËNËS I NAUN PRIFTIT

Nauni me të tjerë luftëtarë erdhi në Tiranë me uniformën e rinisë së Bashkimit.

Porsa u qetësua gjëndja ai erdhi në shkollë për t'u takuar me mua dhe me disa të tjerë nga Fieri, të cilët nuk kishin qënë nxënësit e tij, por që kishin dëgjuar për 'të.

Kur u takua me mua më tha «Ja, koha mbrijti; populli ja theu turinjtë bejlerëve, deti u mbush me dallkawkë, ua mbathën këmbëve me në krye xhelatin Zog». Me sa gëzim ai fliste për triumfin e revolucionit dhe mbi reformat që do të bëheshin, sidomos për reformën agrare.*

Për kujtim bëme një fotografi, ku Nauni ka dalë i armatosur ashtu sikundër ishte dhe me uniformën e Bashkimit.

Në pushime u ktheva në Fier, ku Naunin e gjeta duke mbajtur fjalime mbi triumfin e revolucionit dhe mbi reformat që do të bëheshin. Populli me gojë hapur dëgjonte këtë gojëmjaltë. Zjarr i lëshonin sytë, kur fliste mbi shfrytëzimin dhe shtypjen e fshatarëve nga Vrionasit e bejlerët e tjerë.

* Shiko shënimin Nr. 17.



Naun Prifti dalë në Tiranë në vitin 1924.

Nga Fieri shkuam në Vlorë. Në të hyrë të Vlorës, te Ullinjët, na priti rinia e Vlorës. Me sa gëzim dhe mikpritje u pritëm prej tyre. Figurat që unë për të parën herë i shihja më dukeshin sikur ishja lindur dhe rritur së bashku me 'ta.

Nuk mund të përshkruhet entuziazmi, që kishte kapur popullin dhe sidomos të rinjtë.

Shkuam te varri i Avni Rustemit dhe atje, pasi ndënjëm disa minuta në gjunjë, filluan fjalimet. Sa krenar ishja unë kur digjonja mësuesin t'im Ai vuri në dukje patriotizmin e Avniut, vuajtjet e popullit nga bejlerët dhe kërkoi që përpara varrit të Avniut të betoheshim se do t'i luftonim bejlerët deri në fund.

Për të fundit herë Naunin e pashë në Tiranë kur po ikte për në Qafë të Tujanit për të luftuar kundra mercenarëve të Zogut.....»

A.Q.P. Kujtime të Jorgji Xoxes për Naun Priftin.
Fondi personal «Naun Prifti».

NGA KUJTIMET E GORI ÇUKOS, BASHKËFSHATAR I NAUN PRIFTIT

Me çlirimin e Tiranës, Nauni shokët e tij ja la Zoi Ndrekos, që e kishte bashkëpuntor dhe vetë u muar me punë të organizatës «Bashkimi». Këtu në fshatin tonë ai krijoi një grup prej pesë shokësh. Nauni bëri një mbledhje në gjithë krahinës e Libofshës dhe punoi Proklammatën e Qeverisë së Fan Nolit, ku bënte fjalë për reformën agrare.

Nauni kudo që mbante fjalime shante bejlerët, të cilët i urrente. Në Lushnjë ai u dha vaj rëcini bejlerëve; kështu për shëmbull ja bëri Mustafa Bej Vokopolës.

Unë di se në kohën kur u bënë votimet për deputet të qeverisë së Fan Nolit, Nauni bëri organizimin e votimeve, ku, si kandidat për deputet, kishim Tunë Gjergjin dhe Sheh Ibrahim Karbunarën²³. Mirpo Shehu ua dha votat bejlerëve. Në një mbledhje që u bë në Tegenë e Karbunarës të Lushnjës, ku isha dhe unë prezent, Nauni i tha shehut: «Turp të kesh, o hajdut, që turpërove këtë burrë plak (për Tun Gjergjin)» Shehu në këtë kohë përgatiti vrasjen e Naunit, por në mbrëmje Nauni e kuptoi dhe natën iku nga Karbunara në mënyrë të mëshehtë.

A.Q.P. Kujtime të Gori Çukos për Naun Priftin, Fondi personal «Naun Prifti».

LAJMI I AGJENSISË TELEGRAFIKE
SHQIPTARE MBI VENDOSJEN E NJË PLLAKE
PËRKUJTIMORE PËR NAUN PRIFTIN
NË GJEORGJI.

TBILISI, 23 shkurt (Tass).

Në kryeqytetin e Gjeorgjisë Tbilisi u vendos që të vihet një pllakë përkujtimore në fasadën e shtëpisë, në të cilën jetoi Naun Prifti, patriot dhe revolucionar shqiptar. Përveç kësaj, nga Tbilisi do të dërgohen në Tiranë sendet personale të këtij patrioti për të ngritur një muze.

Në degën gjeorgjiane të Institutit të marksizëm-leninizmit pranë Komitetit Qëndror të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik janë mbledhur materiale të gjëra mbi jetën dhe veprimtarinë e Naun Priftit në Gjorgji. Këto materiale u nisën gjithashtu për në Shqipëri.

Pasi mori pjesë aktive në luftën për çlirim e Shqipërisë, Naun Prifti emigroi në vitin 1925 në Bashkimin Sovjetik. Prej nëntorit të vitit 1926 ai jetoi në Gjeorgji, ku ishte punonjës shkencor. Naun Prifti dha mësim në shkolla të ndryshme të larta të Republikës dhe bëri punë udhëheqëse.

Në varrin e Naun Priftit, i cili vdiq në vitin 1934 në Gulrips (bregdeti gjeorgjian), po vendoset një pllakë-përmendore.

Marrë nga gazeta

«Bashkimi» datë 24 shkurt 1960.

NGA LAJMI I BOTUAR NË GAZETËN
«ZËRI I POPULLIT» ME TITULL «PËRKUJTO-
HET 62-VJETORI I LINDJES SË REVOLU-
CIONARIT KOMUNIST NAUN GRIGOR
PRIFTIT».

Fier, 27 (Koresp. i «Zërit të Popullit»). Këto ditë Komiteti i Partisë për rrethin e Fierit organizoi në Muzeun Lokal të Qytetit një mbledhje përkujtimore kushtuar 62-vjetorit të lindjes së revolucionarit komunist Naun Grigor Prifti. Në mbledhje foli Drejtori i shkollës së partisë «V.I. Lenin» shoku Jorgji Sota. Ai theksoi punën dhe meritat e mëdha të revolucionarit Komunist Naun Grigor Prifti, i cili ka luftuar me mish e me shpirt për çlirimin e popullit të tij nga zgjedha e bejlerëve dhe feudalëve dhe nuk pushoi së luftuari për çështjen e marksizëm-leninizmit deri në fund të jetës së tij. Oratori theksoi se Naun Grigor Prifti vdiq në Bashkimin Sovjetik më 1934, duke qënë anëtar i denjë i partisë së madhe të Leninit.

Me këtë rast në Muzeun Lokal u vendosën disa sende personale të shokut Naun Grigor Prifti, që u suallën nga Bashkimi Sovjetik; shtrati, tavolina e tij e punës, disa libra dhe orendi të ndryshme.»

Marrë nga gazeta «Zëri i Popullit» Nr. 153, datë 28.6.1960.

SHËNIME

1. Naun Grigor Prifti (Doko) — (f. 3) — Në autobiografinë dhe në të gjitha dokumentat zyrtare Nauni ka përdorur mbiemrin Prifti, kurse nga të dhënat e njerëzve të fafesisit të vet del se mbiemri i tij në fshat ka qënë Doko. Për këtë arsye është vënë në kllapa edhe ky mbiemër.

2. Traktati i fshehtë i Londrës, (f. 8) — U përfundua më 26 prill 1915 në mes të qeverive të Anglisë, Francës, Ruisë cariste dhe Italisë. Ky traktat kishte për qëllim të fuste Italinë në luftë në anën e Antantës. Përveç të tjerave ai parashikonte copëtimin e Shqipërisë në mes Italisë, Greqisë dhe Sërbisë. Ky traktat u denoncua nga Qeveria Sovjetike sipas vendimit të Kongresit II të Sovjetëve më 1917.

3. Qeveria tradhëtare e Durrësit. (f. 8) Në Fillim kjo Qeveri doli nga Kongresi i Durrësit, që u hap më 25 dhjetor 1918. Në të përveç elementëve të mira, hynë dhe njerëz që ishin gati t'i sakrifikonin interesat kombëtare në favor të Italisë imperialiste, si vetë kryeministri Turhan Pasha, Mustafa Kruja, Myfit Bej Libhova, Fejzi Bej Alizoti etj. Kjo Qeveri zbatoi një politikë antishqiptare, kolonizuese pro italyane. Ajo u përpoq të ndalonte mbledhjen e Kongresit të Lushnjës, i cili për veprimtarinë e saj antikombëtare e rrëzoi.

4. Babica dhe Kota, (f. 9) — Janë nga vëndet ku u zhvilluan luftime të ashpra në luftën e Vlorës më 1920 kundër pushtuesve italianë. Në luftimet kundër garnizonit italian të Kotës, në qershor 1920, armiku u shpartallua krejt. Midis të vrarëve ishte dhe gjenerali E. Goti. Kryengritësit shqiptarë kapën lart nga 600 ushtarë e oficerë robër.

5. **Avni Rustemi.** (F. 10) (1895-1924) patriot dhe udhëheqës i shquar i lëvizjes demokratike në Shqipëri, kryetar i shoqërisë «Bashkimi». U vra tradhëtisht nga Ahmet Zogu me 22 prill 1924 në Tiranë.

6. **Kongresi Kombëtar i Lushnjës.** (F. 10) — U hap më 21 janar 1920, por me qënë se shumë delegatë nuk kishin mundur të vinin në kohë punimet u zhvilluan prej 28 gjer 31 janar 1920. Në të morën pjesë 50 delegatë nga gati të gjitha krahinat e vendit.

Kongresi mori në shqyrtim dhe hodhi poshtë me urrejtje planet e Konferencës së Paqës për copëtimin e Shqipërisë sipas Traktatit të Londrës (shiko shënimin Nr. 2).

Kongresi rrëzoi Qeverinë antikombëtare të Durrësit dhe zgjodhi qeverinë kombëtare të kryesuar nga Sulejman Delvina.

7. **Bashkimi.** (F. 11) Organizatë demokratike, vazhduese e Federatës «Atdheu», themeluar me inisiativën e Avni Rustemit në fund të vitit 1922, me qendër në Tiranë dhe me degë të saj në qytete e në fshatra të Shqipërisë. Bëri një luftë të ashpër triumfin e lirive demokratike dhe demokratizimin e vëndit. Kjo organizatë luajti një rol të rëndësishëm në revolucionin demokratiko-borgjez të qershorit 1924.

8. **Halim Xhelo,** (F. 15) — Patriot revolucionar, ka lindur në vitin 1894 në katundin Tërbaç të Vlorës. Qysh në moshë të re mori pjesë në jetën politike të vendit. Në vitin 1911 ka marrë pjesë në lëvizjen kryengritëse kundër regjimit turk dhe është burgosur për 7 muaj. Në vitin 1920 ka marrë pjesë në luftën e Vlorës kundër imperialistëve italianë, në 1924 ka qënë redaktor i gazetës përparimtare «Politika» të Vlorës, ka marrë pjesë në revolucionin demokratik borgjez të 1924-tës, pas dështimit të të cilit emigroi jashtë shtetit, ku vazhdimisht mori pjesë në jetën politike për të mirën e popullit të tij. Në vitin 1930 u pranua në Partinë Komuniste të Svicrës, ku punoi në Redaksinë e gazetës «Liria kombëtare» dhe në udhëheqjen e Komitetit të çlirimit nacional. Në vitin 1932 Halimi hyri ilegalisht në Shqipëri, por nga ndjekjet e forta u detyrua të dalë përsëri jashtë shtetit. Halim Xhelua gëzonte mjaft simpati në masat e popullit dhe në pu-

nëtorët. Në vitin 1936 ai shkoi në Moskë për të marrë pjesë në një mbledhje lidhur me detyrat e reja që dilnin për lëvizjen komuniste në Shqipëri pas Kongresit VII të Kominternit më 1935, por sëmundja e kishte mposhtur dhe në shkurt të vitit 1937 vdiq në Moskë.

9. Riza Cerova. (F. 15) — (1896-1935). Patriot revolucionar, që luftoi kundër forcave të errësirës të kryesuara nga satrapi Ahmet Zogu dhe reaksionarët e tjerë. Në dhjetor 1924 emigroi jashtë atdheut, ku mori pjesë në Konare dhe vazhdoi luftën e tij revolucionare. Në vitin 1935 u kthye në Shqipëri dhe mori pjesë në lëvizjen e Fierit, që u bë më 14 gusht 1935. Me disfatën e saj u vra në përpjekje me forcat mercenare të Zogut.

10. Qeveria reaksionare e Tiranës. (F. 16) — Periudha janar-qershor 1924 karakterizohet nga një krizë revolucionare. Më 23 shkurt 1924, nën presionin e **opinionit publik, A. Zogu dha dorëheqjen. Qeverinë e formuan çifligarët e mëdhenj dhe agjentët e imperia- lizmit Shefqet Vërlaci (kryeministër) Myfit Libhova, Iliaz Vrioni etj. Në të vërtetë prapa qeverisë vepronte A. Zogu, i cili, si komandant i përgjithshëm i ushtrisë, po merrte të gjitha masat për organizimin e reaksionit. Qeveria e Sh. Vërlacit u detyrua, më 27 Mars 1924 të japë dorëheqjen. Qeverinë e re e kryesoi çifligari I. Vrioni, i cili u gjend përpara revolucionit demokratik-borgjez.**

11. Kominterni: (F. 17). (Internacionalia Komuniste). Organizatë revolucionare ndërkombëtare, qëndër udhëheqëse e lëvizjes punëtore, që ka ekzistuar prej vitit 1919 gjer në 1943.

Në Kongresin I të Kominternit, që u bë më datën 2-6 mars 1919 me inisiativën dhe nën udhëheqjen e Leninit, morën pjesë përfaqësues të partive dhe grupeve komuniste nga 30 vende.

Internacionalja III Komuniste u bë qëndër e fuqishme e lëvizjes punëtore e komuniste ndërkombëtare. Ajo lojti një rol të madh historik sepse vendosi lidhje midis punonjësve të vendeve të ndryshme, ndihmoi në krijimin e partive të proletariatit të tipit të ri në shembull të Partisë Bolshevike në vende të ndryshme të botës, përpunoi çështje teorike dhe taktike të lëvizjes punëtore në kushte të reja dhe mbrojti marksizëm-lenin-

nizmin nga vulgarizimi dhe shtrëmbërimet e oportunistëve të kallëpeve të ndryshme. Duke marrë parasysh rrethanat e reja Presidiumi i Komitetit Ekzekutiv të Kominternit, në maj 1943, vendosi shpërndarjen e Internacionales Komuniste.

12. **Gazeta «Drita»** (F. 18). Kjo që doli në Gjirokastër është një ndër ato gazeta e revista, që bënë një luftë të vendosur për përparimin ekonomik e shoqëror, për mbrojtjen e lirive demokratike dhe të pavarësisë së vendit.

13. **Shpallja e Ligjit të Reformës agrare.** (F. 19). — U bë nga Këshilli Antifashist Nacional-Çlirimtar më 29 gusht 1945 (shiko gazetën zyrtare» Nr. 39, viti 1945). Nga reforma agrare përfituan 21544 familje pa tokë dhe 48667 familje me pak tokë. Zbatimi i Reformës agrare ishte një revolucion i vërtetë agrar në vendin tonë, që jo vetëm çrrënjosi feudalizmin, por preku thellë edhe bazat e kapitalizmit në fshat.

14. **Taf Kaziu.** (F. 21). Agjent i shovinistëve serbë. Më von u bashkua me Zogun.

15. **Konare.** (F. 24). — Komiteti Nacional-revolucionar i formuar në vitin 1925 në Vienë nga emigrantët politikë, që u mërguan jashtë shtetit pas disfatës së revolucionit të 1924-ës. Kryetari i saj ishte Fan Noli. Me shpalljen e saj të 5 majit 1925 Konareja demaskonte qëllimet e imperialistëve e të shovinistëve fqinjë dhe jepte programin e saj nacional. Në këtë organizatë në fillim bënë pjesë edhe elementë të krahut të djathtë, të cilët, në vitin 1927, u shkëputën dhe krijuan organizatën tradhëtare «Bashkimi Kombëtar». Më vonë pas kësaj ndarjeje Kinareja u quajt «Komiteti i çlirimit nacional», që mbeti një organizatë revolucionare demokratike.

16. **Liria Kombëtare.** (F. 24). Organ i Konare-së dhe pastaj i «Komitetit të çlirimit nacional».

17. **Grupi Komunist shqiptar në Bashkimin Sovjetik.** (F. 29). — U formua më 25 gusht të vitit 1928 në Moskë. Në këtë grup merrnin pjesë emigrantë politikë shqiptarë. Për drejtimin e punës së grupit në mbledhjen e 25 gushtit 1928 u zgjodh komisioni inisiator, i cili u quajt komisioni i përgjithshëm. Ky grup ka ekzistuar gjer nga fundi i 1930-ës kur u vendos që grupi të shpërndahej

dhe që shokët e grupit të venin në Shqipëri, ku të punonin për formimin e partisë komuniste shqiptare.

18. **Tajar Zavalani.** (F. 30). Dezertor, tradhëtar, agjent i imperializmit dhe tani armik i popullit shqiptar.

19. **Ali Kelmendi:** (F. 32). — (1900-1939). Militant i shquar i lëvizjes komuniste shqiptare. Ai është një nga revolucionarët e parë të popullit tonë që ngriti flamurin e luftës në emër të ideve të mëdha të marksizëm-leninizmit. Aliu dhe vëllaj i tij i madh Isnin në lidhje me Bajram Currin dhe luftuan krah për krah me të. Mori pjesë në Revolucionin e Qershorit 1924, emigroi jashtë atdheut në vitin 1924 dhe në vitin 1925, bashkë me Naun Priftin etj. shkoi në Bashkimin Sovjetik, ku vazhdoi kurse të ndryshme dhe punoi. Në 3 mars 1929 pranohet si anëtar i grupit Komunist Shqiptar në Bashkimin Sovjetik. Aliu ishte pranuar gjithashtu në radhët e Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik.

Ali Kelmendi u kthye me mision në Atdhe në vitin 1930, ku zhvilloi një punë të gjerë e të shëndoshë për organizimin e lëvizjes komuniste në Shqipëri. Për çështje pune ai doli disa herë jashtë, u internua nga Qeveria e Zogut dhe, në shtator të vitit 1936, u largua përgjithmonë nga Shqipëria për në Francë. Këtu punoi vazhdimisht, luftoi kundër tradhëtarit Zai Fundo, por sëmundja e keqësoi shumë shëndetin e tij dhe më 11 shkurt 1939 vdiq në një spital të Parisit. Aliu vdiq, por çështja për të cilën ai luftoi, triumfoi në Republikën Popullore të Shqipërisë.

20. **Buharini:** (F. 43). Tradhëtar dhe armik i Bashkimit Sovjetik dënuar nga gjyqi i vitit 1937.

21. (F. 47). — Naum Prifti vdiq në moshën 36 vjeç dhe jo në moshën 31 vjeç sikundër thuhet gabimisht në artikullin e gazetës «Liria Kombëtare».

22. «Triumfi i Legalitetit» (F. 48). Është fjala për rivendosjen e diktaturës të satrapit Ahmet Zogu më 24 dhjetor 1924, pas disfatës të Revolucionit demokratik-borgjez të Qershorit.

23. **Sheh Ibrahim Karbunara.** (F. 60). Armik i be-tuar i popullit, politikan dallaverexhi, njeri i dyzet flamurëve, tradhëtar, një nga inisjatorët kryesorë të organizatës së grupit të deputetëve dhe i gjithë kriminalitetit të saj, kundër të cilëve u zhvillua gjyqi i popullit në Shtator 1947.

L È N D A

	Faq
I. Biografi e shkurtër.....	0
Jeta dhe veprimtaria e Naun Priftit në mërgim	23
II. Pjesë të nxjerra nga letra të Naun Priftit	37
III. Kujtime dhe shkrime për Naun Priftin..	47
Shënime	63